MINSTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
E KOSOVËS

# KURRIKULA E SHKOLLËS SHQIPE TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË

Prishtinë, nëntor 2007

Redaksia:

*Dr. Fehmi Ismaili (kryeredaktor)*
*Mr. Miranda Kasneci*
*Ramush Lekaj*
*Nuhi Gashi*

Lektor

*Nuhi Gashi*

PËRMBAJTJA E LËNDËS


1. Hyrja **5**

2. Parimet e përgjithshme **7**

3. Qëllimet e përgjithshme të kurrikulës **9**

4. Objektivat e përgjithshme dhe specifike të kurrikulës **10**

5. Përmbajtjet /tërësitë tematike dhe temat/ **14**

6. Zbërthimi - përpunimi i përmbajtjeve – objektivave,
rezultatet e pritshme dhe literatura e burimet tjera mësimore **15**

7. Udhëzimet didaktike-metodike për zbatimin e kurrikulës **64**

8. Kuadri dhe përgatitja e tij profesionale **76**

9. Hapësira dhe pajisjet **77**

10. Vlerësimi /evaluimi/ i kompetencave **78**

11. Plani mësimor **80**

# 1. HYRJA

Është e drejtë themelore njerëzore ruajtja dhe kultivimi i identitetit kombëtar. Shenja e parë dhe më e rëndësishme e këtij identiteti është gjuha amtare. Mësimi i gjuhës amtare në shkollë nënkupton edhe mësimin për kulturën e origjinës dhe përbërësit e saj. Në kushtet e jetës jashtë Atdheut[1] ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar vështirësohet dhe kjo manifestohet shumë më tepër te brezat e rinj, posaçërisht te fëmijët e lindur atje. Prandaj, institucioni më i përshtatshëm, ku mësohen e zhvillohen kompetencat gjuhësore e kulturore me përkujdesje profesionale, është shkolla. Dhe kjo shkollë tashmë njihet me emërtimin Shkolla Shqipe e Mësimit Plotësues në diasporë.

Kurrikula e Shkollës Shqipe të Mësimit Plotësues në diasporë në radhë të parë i dedikohet fëmijëve dhe të rinjve (nxënësve) shqiptarë të cilët jetojnë jashtë Atdheut. Ky dokument është pjesë e synimit të përhershëm për vetëdijesimin e vazhdueshëm të brezave të rinj për gjuhën dhe kulturën e origjinës, si përparësi dhe veçanti e identitetit të tyre personal e kolektiv kombëtar, në njërën anë, dhe si mbështetje e bazë e mirë për integrimin e tyre në shoqërinë ku jetojnë, në anën tjetër. Po ashtu ajo i hap shteg edhe synimit për kthim në Atdhe dhe integrim më të lehtë e më të natyrshëm në shoqërinë e tij.

Kjo kurrikul është konceptuar si tërësi komplekse dhe integrale e përbërë nga një grup lëndësh, që së bashku ofrojnë njohuri të mjaftueshme për thesarin gjuhësor, artistik, kulturor, historik e natyror kombëtar. Lëndët[2]: *gjuhë dhe letërsi shqipe, histori, gjeografi, kulturë muzikore dhe kulturë figurative* ofrojnë përmbajtje tematike orientuese të mjaftueshme për zhvillimin e identitetit kombëtar.

Kjo kurrikul, me qëllimet, objektivat, përmbajtjet tematike dhe

---

[1] Një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve (së paku ¼ e kombit) janë detyruar të mërgojnë jashtë Atdheut për arsye të ndryshme (politike, ekonomike etj.). Kjo dukuri e ka përcjellë kombin tonë në periudha të ndryshme dhe me intensitet të ndryshëm. Megjithatë, për fat të mirë, zakonisht lidhja e mërgatës me Atdheun ka qenë e fuqishme. Dhe, në rrethanat e sotme kjo lidhje duhet të forcohet edhe më shumë, andaj kjo kurrikul e re, dedikuar nxënësve tanë në mërgim, është edhe një përpjekje në këtë plan.

[2] Duhet pasur parasysh se klasifikimi i përmbajtjeve dhe interpretimi e zbërthimi i objektivave sipas lëndëve është bërë për shkaqe të një orientimi më të lehtë të mësuesit, përndryshe, ashtu si vetë ora mësimore, kjo kurrikul është e tipit të integruar. Pra, në praktikë, nuk ka orë mësimore të shenjuar-specifikuar sipas lëndëve, por të gjitha lëndët janë aty.

metodologjinë bashkëkohore ndërvepruese, është e hapur dhe e përshtatshme edhe për nxënësit tjerë jo shqiptarë që shprehin interes për ta mësuar gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Po ashtu kjo kurrikul, si për nxënësit shqiptarë ashtu edhe për ata që dëshirojnë ta mësojnë gjuhën shqipe, përbën një mësim shtesë krahas mësimit të rregullt dhe është një mbështetje e mirë në formimin sa me të plotë të personalitetit të tyre, duke i zhvilluar dhe pasuruar kompetencat dhe potencialet intelektuale, estetike, morale dhe sociale, duke nxitur njëkohësisht komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të kulturave të ndryshme.

Realiteti socio-psikologjik dhe kulturor i fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë në diasporë kërkon mbështetjen e tyre për integrim në shoqërinë vendore, ku dija e kompetenca për gjuhën dhe kulturën e origjinës, dygjuhësia, shumëgjuhësia e multikultura konsiderohen përparësi e zhvillimit personal e kolektiv në të gjitha fushat.

Kjo pretendon të jetë një kurrikul bashkëkohore e orientuar përmes objektivave për arritjen e rezultateve të pritshme. Është fleksibile për t’iu përshtatur kushteve dhe niveleve të ndryshme të zbatimit praktik. Për lehtësi kuptimi, interpretimi dhe zbatimi kjo kurrikul është strukturuar në tërësi, përmbajtje dhe njësi tematike. Si e tillë është më inventive, më shteruese në misionin e saj për nxënësit, mësuesit dhe prindërit.

Ky dokument përmban edhe udhëzimet e nevojshme metodike-didaktike, të specifikuara sipas fushave kurrikulare e veçorive të tyre dhe në harmoni me zhvillimet bashkëkohore në arsim, duke marrë për bazë interesimet, mundësitë, aftësitë dhe moshën e nxënësve. Me qëllim të krijimit të lehtësive të interpretimit dhe të zbatimit, në një masë të mjaftueshme, është bërë edhe një lloj specifikimi lëndor në kuptim të përmbajtjeve, qëllimeve, objektivave dhe të rezultateve. Po ashtu për të pasur parasysh edhe shkallën e përfshirjes përmbajtjesore, në krijimin e kësaj kurrikule në kontekst të lëndëve-fushave kurrikulare, është ndërtuar edhe plani orientues mësimor, i cili gjithnjë duhet të rishqyrtohet nga mësuesi dhe t’i përshtatet rrethanave konkrete të mësimit.

Kjo kurrikul është hartuar që të realizohet në 4 nivele-cikle klasash dhe është në ujdi edhe me udhëzimin përkatës administrativ të MASHT të Kosovës për mësimin plotësues në diasporë, të hartuar në bazë të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës[3]. Ajo po ashtu është në ujdi edhe me dispozitat përkatëse të shteteve ku jetojnë shqiptarët dhe të shteteve pritëse ku jeton e punon mërgata shqiptare. Një harmonizim i saj konceptual dhe përmbajtjesor është bërë edhe me kurrikulat përkatëse të shteteve përkatëse në të gjitha fushat.

Niveli i parë përfshin klasat I-III.

Niveli i dytë përfshin klasat IV-VI.

Niveli i tretë përfshin klasat VII-IX.

Niveli i katërt përfshin klasat X-XII[4].

## 2. PARIMET E PËRGJITHSHME

Hartimi dhe zbatimi i kësaj kurrikule ka për bazë një numër parimesh të përgjithshme të njohura, ndër të cilat veçohen:

### *2.1. Parimi i interesit kombëtar*

Ky parim *i* referohet tri qëllimeve kryesore të kurrikulës të shprehura në raportet: shkolla dhe identiteti kombëtar, shkolla dhe integrimi, shkolla dhe kthimi në Atdhe. Identiteti kombëtar dhe kulturor i shqiptarëve në diasporë ngulmueshëm, natyrshëm e me krenari ndjehet e akceptohet unik dhe asisoj është projektuar edhe në këtë kurrikul. Megjithatë, kjo, përveç se identifikon dhe përcakton minimumin e domosdoshëm të kompetencave në kuadër të synimit të ruajtjes dhe zhvillimit të këtij identiteti, merr parasysh dallimet ekzistuese juridike e administrative të shtrirjes hapësinore shumështetëshe të shqiptarëve. Njëkohësisht, ky dokument, në realitetin shkollor të shumësisë së ekzistimit dhe të përdorimit të plan-programeve ose planeve mësimore, të hartuara nga institucionet përkatëse zyrtare të shteteve të ndryshme (qofshin ato lokale-komunale ose regjionale a kantonale, varësisht prej formave të organizimit të shteteve, ose edhe brenda themelatave kulturore-arsimore

[3] Udhëzim administrativ për Shkollat e mësimit plotësues në gjuhën amtare në diasporë, numër [I]10/2005 (MASHT), datë 04.03.2005.

[4] Kurrikula për këtë nivel do të hartohet më vonë.

të mërgatës shqiptare), paraqet edhe një *kurrikul kornizë* integruese, që definon të përbashkëtat kombëtare optimale të qëllimeve, objektivave, standardeve, kompetencave dhe të rezultateve të pritura.

## *2.2.Parimi i përfaqësimit të ekuilibruar*

Në fushat përkatëse kurrikulare kërkohet një përfshirje e ekuilibruar dhe në përputhje me kërkesat kulturore-arsimore të fëmijëve dhe të rinjve e në harmoni me qëllimet dhe objektivat e këtij dokumenti.

## *2.3.Parimi vazhdimësisë dhe koherencës*

Ky parim ka të bëj me lidhjen ***dhe*** harmonizimin adekuat të elementeve në planin e shtrirjes së gjerësisë dhe të thellësisë.

## *2.4.Parimi i shumësisë së metodave dhe të qasjeve*

Respektimi dhe afirmimi i *zgjedhjes së lirë të metodave nënkupton raport të hapur ndaj* të gjitha qasjeve, ku interes të veçantë paraqesin edhe përvojat e fituara të mësimdhënësve në vendet pritëse. Pra, ky lloj mësimi kërkon shumësi metodash dhe përgatitje adekuate për realizimin e punës mbi bazën e qëllimeve të përgjithshme dhe të objektivave të cilat përcaktojnë standardin e dijeve, shkathtësive, qëndrimeve etj. Të gjitha këto paraqesin faktorë me rëndësi të veçantë që ofrojnë modalitetet më të kapshme për realizimin e programit, duke i respektuar dhe zbatuar rrugët dhe stilet e ndryshme individuale të të mësuarit me nxënësin në qendër, nxënësin subjekt në mësim dhe rolin e tij aktiv e krijues (nxënësit si partnerë në mësim).

## *2.5.Parimi i gjithëpërfshirjes*

Gjithëpërfshirja nënkupton kompaktësinë dhe integralitetin brenda hapësirës dhe identitetit kombëtar dhe si e tillë eviton çdo dallim të mundshëm shtetëror, krahinor, regjional, fetar, gjinor etj.

Gjithëpërfshirja në mësim, përveç fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë, nënkupton edhe të interesuarit joshqiptarë për mësimin e gjuhës dhe të kulturës shqiptare.

### *2.6. Parimi i fleksibilitetit*

Fleksibiliteti manifestohet posaçërisht në raportin e hapur dhe ndërveprues me sistemin shkollor, me përmbajtjet kurrikulare dhe me vlerat e shoqërisë vendore. Duke marrë parasysh kushtet dhe rrethanat socio-kulturore, familjare e psikologjike të nxënësve tanë në diasporë, kjo kurikulë është fleksibile në raport me kurrikulën vendore dhe jo në pak raste dhe vende është pjesë përbërëse e saj.

### *2.7. Parimi i* **interkulturalitetit**

Të mësuarit në ambiente shumëkulturore e shumëgjuhësore kërkon dhe mundëson ndërveprime normale të vlerave dhe të kulturave si përparësi dhe në përputhje me standardet e shkollës moderne dhe shoqërisë së sotme globale.

*Mbi këto parime kryesore dhe të tjera mbështetet modelimi teorik dhe ndërtimi i kësaj kurrikule, qëllimet e përgjithshme dhe të veçanta sipas lëndëve-fushave mësimore, objektivat, përmbajtjet, rezultatet e pritshme, vlerësimi, burimet, resurset themelore njerëzore, materialet mësimore, literatura etj.*

## 3. QËLLIMET E KURRIKULËS

1. Zhvillimi dhe ruajtja e identitetit kombëtar përmes mësimit të gjuhës[5], kulturës së origjinës si dhe njohja me trashëgiminë dhe thesarin kulturor, natyror dhe historik kombëtar;

[5] Përveç dokumenteve e konventave ndërkombëtare e regjionale, që e mbrojnë gjuhën amtare e të cilave njëkohësisht ju referohet kjo kurrikul dhe do të duhej t'iu referohej edhe puna e SHSHMP në situata konkrete, në kalendarin kulturor të Evropës dhe të botës janë edhe disa data me interes, të cilat duhet të gjenden në planet e punës së mësuesve të SHSHMP dhe të shënohen me aktivitete konkrete. Të tilla janë: 26 shtatori - Dita Evropiane e Gjuhëve (Këshilli i Evropës) dhe 21 Shkurti - Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare (UNESCO).

2. Edukimi dhe zhvillimi i interesit për njohjen dhe përdorimin e gjuhës e të letërsisë shqipe në të gjitha rrethanat dhe ambientet e komunikimit;
3. Zhvillimi i njohurive dhe i qëndrimit pozitiv për historinë dhe kulturën e kombit shqiptar si pjesë përbërëse e qytetërimit evropian e botëror;
4. Zgjerimi dhe thellimi i njohjes për thesarin shpirtëror, material, kulturor e historik kombëtar;
5. Zhvillimi e kultivimi i vazhdueshëm i ndjenjës së të qenit krenar për përkatësinë kombëtare dhe pjesë e hapësirës shpirtërore-kulturore unike shqiptare;
6. Krijimi dhe zhvillimi kompetencave të domosdoshme gjuhësore e kulturore etnike, si bazë për integrim më të lehtë dhe të natyrshëm në shoqërinë vendore;
7. Krijimi i qëndrimit pozitiv ndaj shumëgjuhësisë dhe interkulturalitetit, si veçori të shoqërisë moderne multikulturore;
8. Përvetësimi dhe thellimi i vazhdueshëm i kompetencave gjuhësore e kulturore kombëtare, si nevojë, "kusht" e përparësi për kthim e integrim më të lehtë në Atdhe.

## 4. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME

Zhvillimi i mësimit plotësues shqip në diasporë për nxënësit shqiptarë, para së gjithash, nënkupton që ata:

- të aftësohen të komunikojnë në gjuhën shqipe në kontekste të ndryshme përmes bisedës, shkrimit, leximit, përfshirë edhe komunikimin artistik**;**
- të njohin, të kuptojnë dhe të çmojnë traditën, vlerat dhe të arriturat kombëtare në letërsi, në arte tjera dhe në veprimtari tjera materiale dhe shpirtërore;
- të njohin, të kuptojnë dhe të analizojnë në mënyrë kritike zhvillimet më të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar, si pjesë e historisë së përgjithshme të njerëzimit;
- të njohin, të kuptojnë, të analizojnë dhe të reflektojnë mbi veçoritë themelore gjuhësore, kulturore, historike, gjeografike e shoqërore të hapësirave ku jeton kombi shqiptar;

- të njohin dhe të kuptojnë domethënien e termave, nocioneve, koncepteve dhe të shprehjeve karakteristike për gjuhën, historinë, gjeografinë, traditën dhe kulturën kombëtare;
- të zhvillojnë vlera, pikëpamje e qëndrime pozitive ndaj të arriturave kombëtare dhe të respektojnë dallimet ekzistuese në kuptimin klasor, gjinor, etnik, kulturor, religjioz etj.

## *4.1. Objektivat specifike për nivelin e parë*

Nxënëset dhe nxënësit duhet:

- të aftësohen për komunikim fillestar dhe të drejtë në gjuhën standarde shqipe për temat e ndryshme[6] përmes bisedës, përshkrimit gojor dhe formave artistike të të shprehurit (recitime, dialogë dhe këngë në përputhje me moshën dhe interesimet e tyre);
- të aftësohen për shkrim e lexim themelor, duke respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit të tingujve e fonemave të gjuhës shqipe;
- t'i zhvillojnë kompetencat gjuhësore në nivel të përdorimit elementar;
- të aftësohen të ndërtojnë drejt fjalitë e thjeshta dhe të dallojnë fjalët e ndryshueshme në gjuhën standarde shqipe;
- të përdorin forma të ndryshme të të shprehurit krijues përmes prezantimeve, bisedave, hartimeve, këngëve, vallëzimeve e vizatimeve për tema e situata të ndryshme;
- të përjetojnë bukurinë e këngës shqipe, duke kënduar dhe dëgjuar disa nga këngët e propozuara ose edhe të tjera;
- të dëgjojnë dhe të përjetojnë vepra muzikore të kompozitorëve shqiptarë nga repertori i zgjedhur i krijimtarisë muzikore kombëtare[7];
- të njohin disa nga veprat artistike të krijuesve përfaqësues figurativë shqiptarë dhe t'i ndërlidhin ato me njësitë tematike të caktuara;
- t'i njohin e t'i përvetësojnë termet, nocionet dhe konceptet themelore historike, gjeografike dhe kulturore të shoqërisë shqiptare, duke u nisur nga familja e deri te koncepti i atdheut.

---

[6] Të orientuara nga tërësitë tematike të propozuara[6] të kurrikulës (shih tabelën).
[7] Veprat e propozuara për dëgjim sipas niveleve.

## *4.2. Objektivat specifike për nivelin e dytë*

Nxënëset dhe nxënësit duhet:

- të zhvillojnë shkathtësitë e komunikimit (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit) në gjuhën standarde shqipe dhe të aftësohen t'i zbatojnë ato drejt në situata të ndryshme;
- të zhvillojnë kompetencat gjuhësore në fushat e drejtshqiptimit, drejtshkrimit si dhe të organizimit logjik të tekstit letrar ose joletrar;
- t'i zhvillojnë kompetencat gjuhësore në nivel të përdorimit të pavarur;
- të kuptojnë dhe të dallojnë ndryshimet ndërmjet gjuhës standarde dhe gjuhës jostandarde;
- të zhvillojnë aftësitë për të shprehur përjetimet, përshtypjet, qëndrimet, shqetësimet, gjykimet dhe vlerësimet nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit me gojë, me shkrim si dhe përmes formave të shprehjes artistike muzikore e figurative;
- të krahasojnë krijimet artistike në letërsi, muzikë dhe arte figurative në Atdhe dhe në vendin ku jetojnë për të parë karakteristikat dalluese dhe të përbashkëta në mes tyre;
- të prezantojnë, të diskutojnë dhe të përshkruajnë ngjarje, vende dhe figura të rëndësishme historike kombëtare, duke përdorur e hulumtuar të dhëna e burime të ndryshme;
- të njohin pozitën dhe shtrirjen natyrore e gjeografike të Atdheut në kontekstin rajonal e evropian;
- të njohin dhe të kuptojnë aspektet themelore të organizimit shoqëror dhe të shtetit në Atdhe dhe t'i dallojnë veçantitë e tyre.

## *4.3. Objektivat specifike për nivelin e tretë*

Nxënëset dhe nxënësit duhet:

- të lexojnë, të zbërthejnë dhe të vlerësojnë tekste informative - publicistike dhe letrare;
- të përvetësojnë dhe të zbatojnë të shkruarit e drejtë e kompetent në gjuhën shqipe standarde;

- t'i zhvillojnë kompetencat gjuhësore në nivel të përdorimit kompetent;
- të përkthejnë tekste nga gjuha shqipe në gjuhën e vendit në të cilën jetojnë dhe anasjelltas;
- të zbatojnë konkretisht dijet për gjuhën e letërsinë shqipe dhe të dëshmojnë për aftësinë e përdorimit të gjuhës standarde shqipe në të gjitha veprimtaritë gjuhësore;
- të lexojnë, të komentojnë e t'i interpretojnë autorët e veprat përfaqësuese të letërsisë shqiptare e t'i krahasojnë me letërsinë e vendit ku jetojnë dhe me atë evropiane e botërore;
- të dëgjojnë e të komentojnë veprat më përfaqësuese të krijimtarisë muzikore shqiptare e t'i krahasojnë me vlerat muzikore të vendit ku jetojnë dhe me ato evropiane e botërore;
- të njohin, të vlerësojnë e të komentojnë veprat më përfaqësuese të krijimtarisë shqiptare të arteve pamore e t'i krahasojnë me vlerat e vendit ku jetojnë dhe me ato evropiane e botërore;
- t'i njohin e t'i vlerësojnë thesarin dhe trashëgiminë kulturore kombëtare dhe t'i krahasojnë me ato të vendit ku jetojnë;
- t'i kuptojnë veçoritë fizike – gjeografike dhe shkallën e zhvillimit shoqëror e ekonomik në Atdhe dhe lidhjet e këtij zhvillimi me vendin ku jetojnë dhe më gjerë;
- të kuptojnë dhe t'u qasen në mënyrë kritike proceseve, ngjarjeve dhe zhvillimeve historike kombëtare në raport krahasimtar me shoqërinë e vendit ku jetojnë dhe zhvillimet globale.

## 5. TËRËSITË TEMATIKE DHE TEMAT[8]

| *Tërësitë tematike* | *Temat* |
|---|---|
| **1. IDENTITETI IM** | 1.1. Unë jam...<br>1.2. Familja ime<br>1.3. Unë dhe bashkësia e ngushtë<br>1.4. Unë dhe bashkësia e gjerë<br>1.5. Unë dhe mjedisi<br>1.6. Atdheu |
| **2. MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË** | 2.1. Shkolla ime<br>2.2. Shkolla dhe komuniteti<br>2.3. Shkolla shqipe në Atdhe<br>2.4. Puna<br>2.5. Profesionet<br>2.6. Veprimtaritë ekonomike<br>2.7. Koha e lirë<br>2.8. Loja |
| **3. NJERËZIT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË** | 3.1.Vendlindja<br>3.2. Banimi dhe vendbanimi<br>3.3. Natyra - veçoritë fizike dhe gjeografike<br>3.4. Popullsia në atdhe – dendësia, migrimet<br>3.5. Koha fizike<br>3.6. Atdheu nëpër kohë<br>3.7. Personalitetet historike |
| **4. KULTURA DHE SHOQËRIA** | 4.1. Kultura e jetesës dhe e mirësjelljes<br>4.2. Të drejtat dhe përgjegjësitë<br>4.3. Institucionet<br>4.4. Qytetërimi shqiptar - arti dhe kultura<br>4.5. Shoqëria bashkëkohore |
| **5. NJË BOTË PËR TË GJITHË** | 5.1. Integrimet dhe globalizmi<br>5.2. Të ndryshëm dhe të njëjtë<br>5.3. Perspektivat e njerëzimit dhe Atdheu |

[8] Në kuadër të këtyre tërësive tematike e temave, hartuesi i tekstit mësimor dhe zbatuesi kryesor i kësaj kurrikule (mësuesi) përdorin edhe tekste tjera letrare ose joletrare, mjete dhe perfomanca multimediale, por gjithnjë në përputhje me qëllimet, objektivat dhe parimet e kësaj kurrikule.

## 6. ZBËRTHIMI – PËRPUNIMI I PËRMBAJTJEVE – OBJEKTIVAVE, REZULTATET E PRITSHME DHE LITERATURA E BURIMET TJERA MËSIMORE

### *6.1. Gjuhë dhe letërsi shqipe*

Zbërthimi bëhet sipas këtyre fushave-kompetencave të gjuhës e letërsisë dhe ka këtë ndërtim:

1. Të dëgjuarit
2. Të folurit
3. Të lexuarit
4. Të shkruarit

*1. Të dëgjuarit - struktura*

1.1. Të dëgjuarit informativ
1.2. Të dëgjuarit efektiv
1.3. Të dëgjuarit e teksteve joletrare dhe letrare
1.4. Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës

*2. Të folurit - struktura*

2.1. Të folurit informativ
2.2. Të folurit aktiv
2.3. Të folurit në funksion të teksteve joletrare dhe letrare
2.4. Të folurit në funksion të përvetësimit të gjuhës

*3. Të lexuarit - struktura*

3.1. Të lexuarit fillestar
3.2. Të lexuarit e teksteve joletrare dhe letrare
3.3. Të lexuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës
3.4. Të lexuarit në funksion të teknikave të leximit

*4. Të shkruarit – struktura*

4.1. Të shkruarit fillestar
4.2. Të shkruarit funksional (zbatues)
4.3. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të njohurive gjuhësore
4.4. Të shkruarit në funksion të përvetësimit të drejtshkrimit dhe shenjave të pikësimit.

### *6.1.1. Niveli i parë (I-III)*

**PËRDORIMI ELEMENTAR I GJUHËS**

| 1. TË DËGJUARIT | PËRMBAJTJET | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| **1.1.<br>Të dëgjuarit informativ** | • Dëgjimi i paraqitjeve të të tjerëve;<br>• Dëgjimi i rrëfimeve nga familja për të afërmit dhe të kaluarën;<br>• Dëgjimi i himnit kombëtar. | ***Nxënësja/nxënësi:***<br><br>• Dëgjon dhe kupton personin që flet;<br>• Respekton folësin dhe dialogon me të. |
| **1.2.<br>Të dëgjuarit efektiv** | • Dëgjimi aktiv i të tjerëve që flasin për temat e caktuara (shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi ku jeton etj.);<br>• Dëgjimi i temave për ekologjinë, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, luftërat etj. | • Dëgjon të tjerët dhe dallon të folurit e tyre;<br>• Kupton kohën dhe hapësirën (dje, sot, nesër);<br>• Zhvillon të dëgjuarit aktiv gjatë rrëfimeve të tjerëve. |
| **1.3.<br>Të dëgjuarit e teksteve joletrare dhe letrare** | • Tekste joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, ekolo-gjik, etik, edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket e zakonet, për sportin, muzikën etj.);<br>• Tekste letrare të formave të thjeshta (fjalë të urta, këngë, legjenda, përrallëza, përralla, gjëegjëza). Poezi, prozë dhe pjesë dramatike të shkurtra. | • Kupton dallimet e teksteve joletrare nga tekstet letrare;<br>• Dallon karakterin e teksteve joletrare;<br>• Dallon poezinë nga proza;<br>• Dëgjon dhe dallon ritmin e poezisë; veçoritë e prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike. |
| **1.4.<br>Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës** | Tingujt zanorë dhe bashkëtingëllorë të gjuhës shqipe;<br>• Shqiptimi i fjalëve të ndryshueshme dhe përdorimi i drejtë i tyre (folja, emri, përemri); | • Dallon të shqiptuarit e tingujve zanorë e bashkëtingëllorë karakteristikë për gjuhën shqipe;<br>• Dallon përdorimin e foljeve ndihmëse **kam** e **jam** në tri kohët kryesore; |

| | | |
|---|---|---|
| | • Përdorimi i gjuhës në tekstet me dialogë, dallimi i fjalisë dëftore dhe pyetëse. | • Dallon emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm, përemrat vetorë;<br>• Mbështetur në intonacionin e zërit, dallon fjalinë dëftore nga fjalia pyetëse. |
| **2. TË FOLURIT** | **PËRMBAJTJET** | **REZULTATET E PRITSHME** |
| **2.1. Të folurit informativ** | • Prezantimi i vetes, anëtarëve të familjes së ngushtë dhe të gjerë, prejardhjes;<br>• Prezantimi i portretit fizik personal (përshkrimi i pjesëve të trupit) dhe dallimi me të tjerët;<br>• Paraqitja e atdheun të prindërve dhe simboleve kombëtare (flamurit, himnit dhe emblemës). | • Paraqet veten dhe të tjerët në kuptimin e njohjes reciproke;<br>• Zotëron të folurit për komunikim të qartë me të tjerët;<br>• Zhvillon kulturën e të folurit si përgjegjësi e komunikimit të qartë; |
| **2.2. Të folurit aktiv në grup** | • Prezantime gojore për tema të caktuara (shkolla, mësimi, ndarja e punëve sipas moshës, koha e lirë, argëtimi, mjedisi jetësor, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, luftërat, etj.) ;<br>• Komunikimi në distancë (telefon, internet dhe forma tjera). | • Zotëron të folurit bindës e argumentues për temat e caktuara që zhvillohen brenda grupit;<br>• Përvetëson të folurit aktiv në bashkëbisedim dhe në grup;<br>• Përvetëson mënyrat e qasjes për komunikim me të tjerët gjatë përdorimit të teknologjisë informative (telefon, internet etj.). |
| **2.3. Të folurit në funksion të teksteve joletrare dhe letrare** | • Tekste joletrare: Nxënësi prezanton gojarisht tekste joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, ekologjik, etik, edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarje, vende dhe figura historike, për sportin, muzikën etj.);<br>• Tekste letrare të thjeshta (fjalë të urta, këngë, legjenda, përrallëza, përralla, gjëegjëza). Poezi, prozë dhe pjesë dramatike. | • Dallon karakterin e teksteve joletrare;<br>• Kupton dallimet mes teksteve joletrare nga tekstet letrare;<br>• Dallon poezinë nga proza;<br>• Dallon ritmin e poezisë dhe të prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike;<br>• Zhvillon të folurit ekspresiv përmes dialogëve. |

| | | |
|---|---|---|
| **2.4. të folurit në funksion në përvetësimit të gjuhës** | • Shqiptimi i tingujve zanorë dhe bashkëtingë-llorë të gjuhës shqipe;<br>• Shqiptimi i fjalëve të ndryshueshme dhe përdorimi i drejtë i tyre (folja, emri, përemri);<br>• Gjuha në tekstet me dialogë (heton fjalitë dëftore dhe pyetëse). | • Përvetëson të shqiptuarit e tingujve zanorë e bashkëtingëllorë karakteristik për gjuhën shqipe;<br>• Dallon: përdorimin e foljeve ndihmëse **kam** e **jam** në tri kohët kryesore, emrat e përveçëm nga emrat e përgjithshëm, përemrat vetorë;<br>• Mbështetur në intonacionin e zërit dallon fjalinë dëftore nga ajo pyetëse. |
| **3. TË LEXUARIT** | **PËRMBAJTJET** | **REZULTATET E PRITSHME** |
| **3.1. Të lexuarit fillestar** | • Leximi i zanoreve dhe bashkëtingëlloreve<br>• (karakteristike për gjuhën shqipe);<br>• Leximi i fjalëve në rrokje, fjalëve të plota dhe togfjalëshave;<br>• Leximi i fjalive të thjeshta dhe teksteve të shkurtra. | • Kupton dhe dallon shqiptimin e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve të gjuhës shqipe me ato të gjuhës së shtetit ku jeton;<br>• Gjatë leximit zhvillon dhe kupton natyrën e shqiptimit të rrokjeve, fjalëve e fjalive të thjeshta. |
| **3.2. Të lexuarit e teksteve joletrare dhe letrare** | • Leximi i teksteve joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, ekologjik, edukativ e historik (për traditat, ve-shjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarje, vende dhe figura historike, për sportin, muzikën etj.);<br>• Tekste letrare të thjeshta (fjalë të urta, poezi popullore, legjenda, përrallëza, përralla, gjë-egjëza). Poezi, prozë dhe pjesë dramatike. | • Dallon të lexuarit mes teksteve joletrare nga tekstet letrare;<br>• Dallon karakterin e teksteve joletrare;<br>• Dallon poezinë nga proza;<br>• Lexon dhe dallon ritmin e poezisë e të prozës dhe pjesëve dramatike;<br>• Zhvillon të lexuarit përmes monologut e dialogut. |
| **3.3. Të lexuarit në fun-ksion të përvetësi-mit të gjuhës** | • Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e lokale në tekste të ndryshme (dallimet);<br>• Fjalia e thjeshtë dhe ndërtimi i saj. | • Dallon gjuhën standarde nga të folmet krahinore e lokale;<br>• Kupton fjalinë e thjeshtë dhe ndërtimin e saj;<br>• Lexon rrjedhshëm tekste me fjali të thjeshta. |

| | | |
|---|---|---|
| **3.4.**<br>**Të lexuarit**<br>**në funksion**<br>**të teknikave**<br>**të leximit** | • Leximi pa zë ose leximi në heshtje;<br>• Leximi me zë: leximi shprehës, leximi gradual, recitimi. | • Mëson dy format kryesore të leximit: leximin pa zë ose në heshtje dhe leximin me zë.<br>• Përvetëson rrjedhshmërinë e gradualitetit të leximit aktiv dhe të recitimit. |
| **4. TË SHKRUARIT** | **PËRMBAJTJET** | **REZULTATET E PRITSHME** |
| **4.1.**<br>**Të shkruarit fillestar** | • Shenjat grafike karakteristike për gjuhën shqipe.<br>• Shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;<br>• Të shkruarit e fjalëve, togfjalëshave, ndarja e fjalëve në rrokje. | • Zotëron shkrimin e drejtë të grafemave, karakteristike për gjuhën shqipe;<br>• Përdorë drejt shkronjat e mëdha dhe shkronjat e vogla;<br>• Mëson ndarjen e fjalëve në rrokje. |
| **4.2.**<br>**Të shkruarit funksional**<br>**(zbatues)**<br>**dhe subjektiv** | • Të shkruarit drejt të zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve të shqipes;<br>• Përshkrimi (në formë elementare) i sendeve, njerëzve, objekteve;<br>• Kopjimi i fjalive dhe teksteve të shkurtra joletrare mbi bazën e modeleve: ftesa, falënderime, njoftime; plotësim formularësh, faturash etj.;<br>• Kopjimi i teksteve letrare dhe shkrimi i biografive, autobiografisë, letrave, ditarit, vjershave, tregimeve, korrespondencave etj. | • Përvetëson shkrimin e zanoreve e bashkëtingëlloreve të shqipes, fjalëve dhe fjalive të thjeshta;<br>• Zhvillon shkrimin komunikues (shkrimi i urimeve, mirënjohjeve, ftesave, njoftimeve, raporteve të shkurtra dhe gjërave tjera të kësaj natyre);<br>• Krijon dhe shkruan për nevoja vetjake sipas udhëzimeve të mësimdhënësit apo modeleve dhe zhvillon shkrimin subjektiv. |

| | | |
|---|---|---|
| **4.3.**<br>**Të shkruarit në funksion të përvetësimit të njohurive gjuhësore** | • Përdorimi gjatë shkrimit i foljeve ndihmëse kam e jam në tri kohët kryesore;<br>• Emrat e përveçëm dhe emrat e përgjithshëm;<br>• Përemrat vetorë në njëjës dhe në shumës;<br>• Fjalia e thjeshtë dëftore dhe fjalia pyetëse. | • Zotëron tri kohët kryesore të foljeve (e shkuara, e tashmja dhe e ardhmja);<br>• Kupton qartë dallimin e emrave të përveçëm nga emrat e përgjithshëm;<br>• Bënë dallimin e përemrave vetorë;<br>• Zotëron shkrimin e fjalive të thjeshta dëftore dhe pyetëse. |
| **4.4.**<br>**Të shkruarit në funksion të përvetë-simit të drejtshkri-mit dhe shenjave të pikësimit** | • Shkrimi shkronjave karakteristike për gjuhën shqipe (të mëdha dhe të vogla);<br>• Shkronjat me dy grafema, shkronja e madhe pas pikës si dhe zanorja ë;<br>• Shenjat e pikësimit: pika, presja dhe pikë-pyetja. | • Zotëron shkrimin e shkronjave të veçanta për gjuhën shqipe;<br>• Përvetëson shkronjat e përbëra prej dy grafemave;<br>• Përvetëson përdorimin e shkronjës së madhe dhe zanores **ë**;<br>• Në fjali përdor drejt shenjat e pikësimit (pika, presja e pikëpyetja). |

### *6.1.2. Niveli i dytë (IV-VI)*

## PËRDORIMI I PAVARUR I GJUHËS

| 1. TË DËGJUARIT | PËRMBAJTJET | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| **1.1.**<br>**Të dëgjuarit informativ** | • Të dëgjuarit e të tjerëve dhe mënyrat e të shprehurit për temat që trajtojnë;<br>• Të dëgjuarit e rrëfimeve nga familjarët dhe të afërmit për vendlindjen, atdheun, përkatësinë kombëtare e fetare si njohje e të kaluarës së largët dhe të afërt;<br>• Të dëgjuarit e himnit kombëtar dhe himnit të shtetit ku jeton. | ***Nxënësja/nxënësi:***<br>• Dëgjon dhe kupton atë që flet;<br>• Respekton folësin dhe dialogon me të;<br>• Zbaton rregullat gjatë intonimit të himneve. |

| | | |
|---|---|---|
| **1.2.**<br>**Të dëgjuarit efektiv** | • Të dëgjuarit aktiv të të tjerëve që flasin për temat e caktuara (shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi jetësor);<br>• Të dëgjuarit e temave për ekologjinë, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, luftërat etj.;<br>• Të dëgjuarit dhe të kuptuarit e rëndësisë së institucioneve vendimmarrëse. | • Dëgjon të tjerët dhe dallon të folurit e tyre;<br>• Kupton kohën dhe hapësirën: dje, sot, nesër.<br>• Zhvillon të dëgjuarit aktiv gjatë rrëfimeve të tjerëve;<br>• Zhvillon kulturën e të dëgjuarit si mundësi argumentimi, bindjeje, qartësie dhe komunikimi reciprok. |
| **1.3.**<br>**Të dëgjuarit e teksteve joletrare dhe letrare** | • Të dëgjuarit e teksteve joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, ekologjik, etik, edukativ e historik (si për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, për hapësirën urbane dhe bukuritë natyrore nga kanë ardhur dhe ku jetojnë, për sportin, muzikën etj.);<br>• Të dëgjuarit e teksteve letrare të formave të thjeshta (fjalë të urta, këngë, legjenda, përra-llëza, përralla, gjëegjëza). Poezi, prozë dhe pjesë dramatike. | • Kupton dallimet e teksteve joletrare nga tekstet letrare;<br>• Dallon poezinë nga proza;<br>• Dëgjon dhe dallon ritmin e poezisë; veçoritë e prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike;<br>• Kupton drejt lidhjen që ka një tekst me muzi-kën, artin figurativ, shfaqjen teatrale e filmike; |
| **1.4.**<br>**Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës** | • Shqiptimi i fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme (folja, emri, mbiemri, përemri, numërori, ndajfolja, lidhëza etj.);<br>• Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e lokale (dallimet);<br>• Përdorimi i gjuhës në tekstet me dialogë dhe diferencimi (dallimi) i fjalive të thjeshta dëftore, nxitëse, pyetëse si dhe i kryefjalës e kallëzuesit brenda tyre;<br>• Fjalia e përbërë dhe ligjërata. | • Kupton fjalët e ndryshueshme dhe të pandry-shueshme;<br>• Kupton gjuhën e folur standarde dhe dallimet me të folmet krahinore dhe lokale;<br>• Mbështetur në intonacionin e zërit dallon qartë fjalinë e thjeshtë, fjalinë e përbërë, ligjëratën. |

| 2. TË FOLURIT | PËRMBAJTJET | REZULTATET E PRITSHME |
| --- | --- | --- |
| **2.1. Të folurit informativ** | • Prezantimi i vetes, anëtarëve të familjes së ngushtë dhe të gjerë, prejardhjes;<br>• Prezantimi i vendlindjes së vet, të prindërve dhe të afërmve;<br>• Paraqitja e Atdheut në kohë dhe hapësirë dhe simbolet kombëtare e shtetërore (flamuri, himni, stema etj.). | • Zotëron të folurit për komunikim të qartë me të tjerët;<br>• Zhvillon kulturën e të folurit si përgjegjësi e komunikimit të qartë; |
| **2. 2. Të folurit aktiv në grup** | • Paraqitjet gojore për tema të caktuara (shkolla, mësimi, ndarja e punëve sipas moshës, koha e lirë, argëtimi, mjedisi ku jeton, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, luftërat; etj.);<br>• Biseda për rëndësinë e institucioneve vendim-marrëse në jetën publike, për pasuritë natyrore dhe ekonomike të vendeve nga kanë ardhur dhe ku jetojnë;<br>• Komunikimi në distancë (telefon, internet dhe forma tjera). | • Zotëron të folurit bindës e argumentues për temat e caktuara që zhvillohen brenda grupit;<br>• Përvetëson të folurit aktiv në bashkëbisedim dhe në grup;<br>• Përvetëson mënyra e qasje të të folurit në komunikim me të tjerët gjatë përdorimit të teknologjisë informative (telefon, internet etj.); |
| **2. 3. Të folurit në funksion të teksteve joletrare dhe letrare** | • Prezantimi gojarisht i teksteve joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popu-llarizues, shkencor, ekologjik, etik, edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarje, vende dhe figura historike, për hapësirën urbane dhe bukuritë natyrore nga kanë ardhur dhe ku jetojnë, për sportin, muzikën etj.);<br>• Tekste letrare: fjalë të urta, këngë, legjenda, | • Kupton dallimet e teksteve joletrare nga tekstet letrare;<br>• Dallon karakterin e teksteve joletrare;<br>• Dallon poezinë nga proza;<br>• Dëgjon dhe dallon ritmin e poezisë; veçoritë e prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike;<br>• Zhvillon të folurit ekspresiv përmes dialogëve;<br>• Kupton drejt lidhjen që ka një tekst me muzi- |

| | | |
|---|---|---|
| | përrallëza, përralla, gjëegjëza. Poezi, prozë dhe pjesë dramatike. | kën, artin figurativ, shfaqjen teatrale e filmike. |
| **2.4. Të folurit në funksion të përvetësimit të gjuhës** | • Shqiptimi i fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme (folja, emri, mbiemri, përemri, numërori, ndajfolja, lidhëza);<br>• Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e lokale (dallimet);<br>• Fjalia e thjeshtë dëftore, nxitëse, pyetëse ;<br>• Kryefjala dhe kallëzuesi;<br>• Fjali e përbërë dhe ligjërata. | • Kupton fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme;<br>• Kupton gjuhën e folur standarde dhe dallimet me të folmet krahinore dhe lokale;<br>• Mbështetur në intonacionin e zërit dallon qartë fjalinë e thjeshtë, fjalinë e përbërë, ligjëratën. |
| **3. TË LEXUARIT** | **PËRMBAJTJET** | **REZULTATET E PRITSHME** |
| **3.2. Të lexuarit e teksteve joletrare dhe letrare** | • Tekste joletrare të karakterit njohës, didaktik, dokumentar, popullarizues, shkencor, ekologjik, etik, edukativ e historik (për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarje, vende dhe figura historike, për hapësirën urbane dhe bukuritë natyrore nga kanë ardhur dhe ku jetojnë, për sportin, muzikën etj.);<br>• Tekste letrare të formave të thjeshta: fjalë të urta, poezi popullore, legjenda, përrallëza, përralla, gjëegjëza. Poezi, prozë dhe pjesë dramatike nga letërsia shqipe. | • Dallon tekstet joletrare nga tekstet letrare;<br>• Kupton dallimet brenda teksteve joletrare;<br>• Dallon poezinë nga proza;<br>• Lexon dhe dallon ritmin e poezisë; veçoritë e prozës, dialogun dhe monologun te pjesët dramatike;<br>• Zhvillon të lexuarit përmes dialogëve;<br>• Kupton drejt lidhjen që ka një tekst me muzikën, artin figurativ, shfaqjen teatrale e filmike; |

| | | |
|---|---|---|
| **3.3.<br>Të lexuarit<br>në funksion<br>të përvetësimit<br>të gjuhës** | • Gjuha standarde nga të folmet krahinor e e lokale (dallimet) në tekste të ndryshme;<br>• Fjalia e thjeshtë, fjalia e përbërë dhe ligjërata si dhe shenjat e pikësimit të përdorura brenda tyre. | • Kupton shenjat e pikësimit dhe përdorimin e tyre në tekste;<br>• Kupton fjalinë e thjeshtë, fjalinë e përbërë dhe ligjëratën mbështetur në intonacion dhe shenja të pikësimit. |
| **3.4.<br>Të lexuarit në funksion të teknikave të leximit** | • Leximi me zë: leximi shprehës, leximi gradual, recitimi, interpretimi (diksioni, intonacioni, ndalesat, shenjat e pikësimit, timbri, tempi i leximit etj.). | • Përvetëson rrjedhshmërinë e gradualitetit të leximit aktiv, të recitimit dhe të interpretimit. |
| **4. TË SHKRUARIT** | **PËRMBAJTJET** | **REZULTATET E PRITSHME** |
| **4.2.<br>Të shkruarit funksional (zbatues) dhe subjektiv** | • Përshkrimi i njerëzve, objekteve, sendeve;<br>• Kopjimi i fjalive dhe teksteve të shkurtra joletrare mbi bazën e modeleve (ftesa, falënderime, njoftime; plotëson formularë, fatura; shkruan pyetje, anketa, intervista etj.);<br>• Kopjimi i teksteve letrare dhe shkrimi i biografisë, autobiografisë, letrës, ditarit, vjershës, tregimit, korrespondencës etj. | • Zhvillon shkrimin komunikues (shkrimi i urimeve, mirënjohjeve, ftesave, njoftimeve, raporteve të shkurtra dhe gjërave tjera të kësaj natyre etj.);<br>• Krijon dhe shkruan për nevoja vetjake sipas udhëzimeve të mësimdhënësit apo modeleve dhe zhvillon shkrimin subjektiv. |
| **4.3.<br>Të shkruarit në funksion të përvetësimit të njohurive gjuhësore** | • Fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme:<br>• Folja – zgjedhimi në kohët e mënyrës dëftore dhe lidhore;<br>• Emri – llojet, gjinia;<br>• Mbiemri - llojet, gjinia;<br>• Përemri- llojet;<br>• Numërori, ndajfolja, lidhëza; | • Përmes zgjedhimit, përkatësisht lakimit, zhvillon njohuritë për fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme;<br>• Njeh tipat kryesore të fjalisë së thjeshtë dhe llojet e fjalisë së përbërë si dhe gjymtyrët e tyre (kryefjala, kallëzuesi). |

| | | |
|---|---|---|
| | • Fjalia e thjeshtë dëftore, nxitëse, pyetëse;<br>• Gjymtyrët kryesore të fjalisë (kryefjala, kallëzuesi);<br>• Fjalia e përbërë. Fjalia e përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje; | |
| **4.4.**<br>**Të shkruarit në funksion të përvetësimit të drejtshkrimit dhe shenjave të pikësimit** | • Shkronja e madhe pas pikës, në fillim dhe brenda fjalisë;<br>• Shkrimi me vend i zanores **ë** dhe bashkëtingëlloreve **gj, xh, q, ç** etj.;<br>• Shenjat e pikësimit: pika, presja, pikëçuditja, pikëpyetja dhe dy pikat. | • Zotëron përdorimin e shkronjës së madhe;<br>• Përvetëson përdorimin e zanores **ë** dhe bashkëtingëlloreve **gj, xh, q, ç**;<br>• Përmes shkrimit të teksteve të ndryshme përvetëson dhe përdor drejt shenjat e pikësimit si: pikën, presjen, pikëçuditjen, pikëpyetjen dhe dy pikat. |

### *6.1.3. Niveli i tretë (VII-IX)*

**PËRDORIMI KOMPETENT I GJUHËS**

| 1. TË DËGJUARIT | PËRMBAJTJET | REZULTATET E PRITSHME |
|---|---|---|
| **1.1.**<br>**Të dëgjuarit informativ** | • Të dëgjuarit e të tjerëve dhe mënyrat e të shprehurit për temat që trajtojnë, marrja e informatave dhe krahasimi tyre. | ***Nxënësja/nxënësi:***<br>• Dëgjon dhe kupton atë që flet;<br>Respekton folësin dhe dialogon me të, sqaron dhe argumenton. |
| **1.2.**<br>**Të dëgjuarit efektiv** | • Të dëgjuarit aktiv të të tjerëve që flasin për temat e caktuara (shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi ku jeton, të drejtat dhe përgjegjësitë individuale e grupore brenda institucioneve); | • Dëgjon të tjerët dhe dallon të folurit e tyre;<br>• Zhvillon të dëgjuarit aktiv gjatë rrëfimeve të tjerëve;<br>• Zhvillon kulturën e të dëgjuarit si mundësi argumentimi, bindjeje, qartësie dhe komunikimi reciprok. |

| | | |
|---|---|---|
| | • Të dëgjuarit aktiv të paraqitjeve të të tjerëve: qëndrimet dhe mendimet për shoqërinë bashkëkohore, dallimet etnike e fetare. | |
| **1.3.<br>Të dëgjuarit e teksteve joletrare dhe letrare** | • Tekste joletrare gazetash, revistash dhe emisionesh televizive (reportazhe, intervista, anketa etj.);<br>• Tekste letrare nga autorë të huaj (poetë, prozatorë, dramaturgë). | • Dallon mënyrat e informimit në shtyp dhe televizion;<br>• Kupton dallimet mes letërsisë shqipe dhe asaj të huaj;<br>• Kupton drejt lidhjen që ka letërsia me muzikën, artin figurativ, shfaqjen teatrale e filmike. |
| **1.4.<br>Të dëgjuarit në funksion të përvetësimit të gjuhës** | • Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e lokale (dallimet);<br>• Përdorimi i gjuhës në tekstet me dialogë;<br>• Figurshmëria dhe semantika e fjalës në tekste të ndryshme. | • Kupton gjuhën e folur standarde dhe dallimet me të folmet krahinore e lokale;<br>• Kupton semantikën e fjalëve brenda fjalisë, periudhës dhe tekstit.<br>• Kupton me thellë kuptimin figurativ të gjuhës. |
| **2. TË FOLURIT** | **PËRMBAJTJET** | **REZULTATET E PRITSHME** |
| **2. 1.<br>Të folurit informativ** | • Identiteti im (prejardhja, përkatësia, gjeneza);<br>• Prezantimi i vendlindjes, atdheut në kohë dhe hapësirë dhe i simboleve kombëtare e shtetë-rore (flamuri, himni, stema, shenjat e figurat emblematike identifikuese kombëtare e shtetërore). | • Zotëron të folurit për komunikim të qartë me të tjerët;<br>• Zhvillon kulturën e të folurit si përgjegjësi e komunikimit të qartë; |
| **2. 2.<br>Të folurit aktiv në grup** | • Brenda grupit merr pjesë aktive në bisedat dhe debatet që zhvillohet për temat e caktuar paraprakisht të cilat janë me interes;<br>• Biseda për rëndësinë e institucioneve vendim-marrëse në jetën publike, funksionimin e tyre | • Zotëron të folurit bindës e argumentues për temat e caktuara që zhvillohen brenda grupit;<br>• Përvetëson të folurit aktiv në bashkëbisedim dhe në grup;<br>• Përvetëson mënyra e qasje të të folurit në |

| | | |
|---|---|---|
| | dhe pjesëmarrjen në to;<br>• Shfaqja e mendimeve dhe mbajtja e qëndrimeve lidhur me problemet e shoqërisë bashkëkohore, për dallimet etnike si pasuri njerëzore;<br>• Komunikimi në distancë (telefon, internet dhe forma tjera). | komunikim me të tjerët gjatë përdorimit të teknologjisë informative (telefon, internet etj.); |
| **2. 3. Të folurit në funksion të teksteve joletrare dhe letrare** | • Diskutimi për llojet e shkrimeve gazetareske;<br>• Mitologjia si formë e komunikimit të hershëm dhe si pasuri e sotme;<br>• Analiza dhe komentimi i poezisë, prozës dhe pjesës dramatike. | • Kupton dallimet e formave të shkrimeve gazetareske;<br>• Komenton tekste dhe figura të mitologjisë shqiptare dhe të krijimeve tjera me shtresime mitologjike (përrallat, legjendat, baladat, këngët e kreshnikëve etj.);<br>• Kupton ngjashmëritë dhe dallimet që kanë tekstet letrare si në formë ashtu edhe në përmbajtje. |
| **2.4. Të folurit në funksion të përvetësimit të gjuhës** | • Gjuha standarde dhe të folmet krahinore e lokale (afritë dhe dallimet);<br>• Fjalia e përbërë, ligjërata, paragrafi, teksti. | • Kupton gjuhën e folur standarde dhe dallimet me të folmet krahinore dhe lokale;<br>• Mbështetur në intonacionin e zërit dallon fjalinë e përbërë, ligjëratën. |
| **3. TË LEXUARIT** | **PËRMBAJTJET** | **REZULTATET E PRITSHME** |
| **3. 2. Të lexuarit e teksteve joletrare dhe letrare** | • Tekste joletrare – gazetareske (informata, intervista, reportazhi);<br>• Tekste të krijimtarisë gojore (përrallat, figurat mitologjike, këngët e kreshnikëve);<br>• Dokumentet e para të shkrimit shqip;<br>• Autorë dhe vepra të letërsisë shqipe sipas | • Kupton strukturën e teksteve gazetareske;<br>• Kupton esencat e mitologjisë shqiptare dhe krijimeve tjera;<br>• Kupton figuracionin e poezisë (ritmi, metafora, simboli, krahasimi etj.);<br>• Veçoritë e prozës (subjekti, ideja kryesore, |

| | | |
|---|---|---|
| | zhvillimit të saj në kohë dhe hapësirë: poezi, prozë, dramë (lloje të ndryshme); | detaji, personazhi);<br>• Kupton historinë e shkrimit shqip;<br>• Dialogu, monologu te pjesët dramatike dhe të komedisë. |
| **3.3.<br>Të lexuarit<br>në funksion<br>të përvetësimit<br>të gjuhës** | • Gjuha standarde dhe format dialektkore;<br>• Leximi i teksteve në dy dialektet e shqipes dhe në gjuhën standarde. | • Nga shembuj konkret kupton afrinë dhe dallimet që kanë dialektet e shqipes në mes veti si edhe me standardin e sotëm të shqipes. |
| **3.4.<br>Të lexuarit në<br>funksion të<br>teknikave të leximit** | • Leximi i teksteve të ndryshme me zë: leximi shprehës, leximi gradual, recitimi, interpretimi, interpretimi në role (diksioni, intonacioni, ndalesat, shenjat e pikësimit, timbri, tempi i leximit, etj.). | • Përvetëson rrjedhshmërinë e gradualitetit të leximit aktiv, të recitimit dhe të interpretimit individual dhe interpretimit në role dramatike. |
| **4. TË SHKRUARIT** | **PËRMBAJTJET** | **REZULTATET E PRITSHME** |
| **4.2.<br>Të shkruarit<br>funksional (zbatues)<br>dhe subjektiv** | • Përshkrimi i njerëzve, objekteve, pamjeve natyrore e urbane;<br>• Kopjimi i paragrafëve dhe teksteve të shkurtra joletrare e letrare;<br>• Shkrimi i biografisë, autobiografisë, letrës, ditarit, vjershës, tregimit, korrespondencës, raportit, komentit, esesë etj. | • Zhvillon shkrimin komunikues përmes përshkrimit;<br>• Krijon dhe shkruan për nevoja vetjake sipas udhëzimeve të mësimdhënësit apo modeleve dhe zhvillon shkrimin subjektiv. |

| | | |
|---|---|---|
| **4.3.<br>Të shkruarit në funksion të përvetësimit të njohurive gjuhësore** | • Fjala:sinonimet, antonimet, homonimet;<br>• Folja – zgjedhimi në kohët e mënyrës kushtore, habitore etj.;<br>• Emri - lakimi, trajta, rasat;<br>• Mbiemri - shkallët, gjinia, lakimi;<br>• Përemri - lakimi,<br>• Numërori, ndajfolja, lidhëza, pjesëza, pasthirrma;<br>• Gjymtyrët e dyta të fjalisë: kundrinori, ndajshtimi, rrethanori;<br>• Llojet e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje;<br>• Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë. | • Përmes zgjedhimit dhe lakimit zhvillon njohuritë për fjalët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme;<br>• Kupton gjymtyrët e dyta të fjalisë si: kundrinorin, rrethanorin, ndajshtimin;<br>• Kupton dhe dallon llojet e fjalisë së përbërë me bashkërenditje dhe me nënrenditje;<br>• Kupton ligjëratën dhe dallon ligjëratën e drejtë nga ligjërata e zhdrejtë. |
| **4.4.<br>Të shkruarit në funksion të përvetësimit të drejtshkrimit dhe shenjave të pikësimit** | • Shkronja e madhe pas pikës, në fillim dhe brenda fjalisë, te emrat e përveçëm etj.;<br>• Shkrimi me vend i zanores ë dhe bashkëtingëlloreve **gj, xh, q, ç, zh, th** etj.;<br>• Shenjat e pikësimit: pika, presja, pikëpresja, pikëçuditja, pikëpyetja, dy pikat, vizë lidhësen dhe tri pikat. | • Zotëron përdorimin e shkronjës së madhe;<br>• Përvetëson përdorimin e zanores **ë** dhe bashkëtingëlloreve **gj, xh, q, ç, zh, th**;<br>• Përmes shkrimit të teksteve të ndryshme përvetëson dhe përdor drejt shenjat e pikësimit si: pikën, presjen, pikëpresjen, pikëçuditjen, pikëpyetjen dy pikat, vizë lidhësen dhe tri pikat. |

### *6.1.4. Katalogu i njësive-teksteve letrare sipas niveleve dhe klasave /propozim/*[9]

| ***NIVELI I PARË*** | | | |
|---|---|---|---|
| **Klasa** | **I** | **II** | **III** |
| ***Njësitë letrare dhe autorët e tyre*** | **Abetarja ose /dhe/ plotësori i abetares** | • Çajupi, *Ku kemi lerë* (poezi)<br>• Qamil Guranjaku, *Vendi im* (poezi)<br>• Agim Deva, *Viti i ri* (poezi)<br>• Ali Huruglica, *Pylli* (poezi)<br>• Naum Prifti, *Guri i Skënderbeut* (prozë)<br>• Alqi Kristo, *Nënë e babë unë i dua* (poezi)<br>• Lumo Skendo, *Eja motër* (prozë)<br>• Rifat Kukaj, *Shkopi magjik* (poezi)<br>• Arif Demolli, *Zogu cicëron …* (prozë)<br>• Gaqo Bushaka, *Vajza e luleve* (prozë)<br>• Rrahman Dedaj, *Tre diejt e Dianës* (prozë)<br>• Këngë popullore për fëmijë: *Dumba moj dumba;*<br>• Përrallë shqiptare: *Çupa që derdhte trëndafila nga goja;*<br>• Përrallëz shqiptare, *Mbreti dhe buburreci*; | • Naim Frashëri, Korça (poezi)<br>• Asdreni, Betimi mbi flamur (poezi)<br>• Spiro Çomora, Pula dhe fiku (poezi)<br>• K. Kristoforidhi, Ylli i vogël lartë në qiell (poezi)<br>• Fejzi Bojku, Kush nuk fle natën (poezi)<br>• Sami Frashëri, Dheu është flori (prozë)<br>• Xhevahir Spahiu, Shqiponja (poezi)<br>• Hajro Ulqinaku, Piktura e mbrëmjes në bregdet (prozë)<br>• Dritëro Agolli, Kali dhe gomari (poezi )<br>• Abdullah Thaçi, Në pritje (poezi)<br>• Përrallëz popullore, Tre qetë dhe ujku<br>• Përrallë popullore, Mollë e artë<br>• Ninullë, Ku i ka nana kta shkodrana;<br>• Anekdotë, Shpata *dhe krahu i Skënderbeut*<br>• Agim Deva, *Të mbjellim nga një dru* (poezi) |

[9] Hartuesi i tekstit mësimor dhe i mjeteve tjera mësimore si dhe mësuesi, kësaj liste mund t' i shtojnë edhe njësi tjera tekstore (letrare e joletrare) e jotekstore /mjete mësimore e burime tjera me interes nga të gjitha fushat kurrikulare/, por gjithnjë në përputhje me parimet, qëllimet, objektivat dhe përmbajtjet e kësaj kurrikule. Ky shënim vlen për të gjitha lëndët (fushat kurrikulare).

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | • Anekdotë: *Kujdesi i Nastradinit*;<br>• Tasim Gjokutaj, *Pse kërkon të bëhesh bletë*? (poezi)<br>• Naim Frashëri: Qeni dhe besa e tij (prozë)<br>• Adelina Mamaqi, Çerdhen do ta ruaj (poezi). | • Naum Prifti, Yllka dhe dallëndyshet (prozë)<br>• Odhise Grillo, Vogëlushi dhe hëna (poezi)<br>• Hivzi Sulejmani, Vendi im i shtrenjtë (poezi)<br>• Rifat Kukaj, Pjeshkët (prozë)<br>• Faik Konica, *Anës liqenit* (prozë). |

| ***NIVELI I DYTË*** | | | |
|---|---|---|---|
|---|---|---|---|
| | • Moj buburrec<br>• Laja, laja etj.<br>• Po nget lepuri hop, hop, hop<br><br>**DËGJIM MUZIKE:**<br>• T. Harapi, Vallja e xhuxhave<br>• Peci, Kecat dhe ujku (balet) | • KAPSAMUN, *Ëndërrime*<br>**Lojëra muzikore/ligjërime ritmike:**<br>• *Ejani flutura, vasha të bukura*<br>• *Lakuriqi natën*<br>• *Shoqe eja të kërcejmë*<br>• *Loja e shqiponjave* | • B. Shehu, *Lepuri me pesë këmbë* (muzikë për film)<br>• Gj. Gjevelekaj, *Impresione për orkestër* |
| **3. NJERËZIT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË** | **INTERPRETIM:**<br>• M. Qafleshi, *Prishtina*<br>• I. Hoxha, *Ora*<br>• I. Hoxha, *Marsi*<br>• Z. Ballata, *Dimri*<br>• P. Badivuku, *Lulet në mars*<br>• Goca e Preshevës (popullore)<br>• B.Mulliqi, *Rik, rik, rik*<br>• G. Avrazi, *Atdheu*<br>• S. Gjinali, *Stinët, muajt e ditët*<br><br>**DËGJIM MUZIKE:**<br>• M. Kacinari, *Drandofilja e vogël*<br>• P. Gaci, *Koncert për violinë e orkestër* (koha e III)<br><br>**LIGJËRIME RITMIKE:**<br>• *Flutur, flutur zonjë e bukur*<br>• *Mori lulja e linit* (popullore) | **INTERPRETIM**:<br>• *Për mëmëdhenë* (patriotike )<br>• R. Rudi, *Sa pyje male*<br>• B. Mulliqi, *Pushimet dimërore*<br>• *Ja, iku dimri* (zvicerane e shqipëruar)<br>• R. Sokoli, *Balonat*<br>• F. Seli, *Këngë e cicërime*<br>• M. Piperku, *Zogjtë dhe flatrat*<br><br>**Këngë popullore:**<br>• Popullore, *A kanë uj'ato burime* (9/8)<br>• Popullore, *Po shkon goca me korr' n'arë* ( 7/8 )<br>• Popullore, *Rrush i kuq* (9/8)<br>• Popullore, *Kënga e ftujkes*<br>• *Mora rrugën për Janinë*<br>• *Erdhi prilli* | **INTERPRETIM:**<br>• M. Piperku, *Pranvera në Prishtinë*<br>• *Kroi i fshatit tonë* (qytetare)<br>• P. Jakova, *Dielli ka prendue* (aria nga opera "Mrika")<br>• S. Spahiu, *Pamje vjeshte*<br>• L. V. Bethoven, *Muzgu* (e shqipëruar)<br>• K. Trako, *Drini plak*<br><br>**DËGJIM MUZIKE:**<br>• R. Mulliqi, *Baresha* (kompozim në frymën popullore, interpretuar nga N. Pagarusha)<br>• F. Beqiri, *Poema dramatike* "Skënderbeu"<br>• Prenk Jakova, aria nga opera |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | **DËGJIM MUZIKE:**<br>• R. Mulliq, *Akuarelet e Prizrenit*<br>• M. Menxhiqi, Oratoriumi: *Homazh Nenës Terezë*<br>• C. Zadeja, *Simfonia nr. 1*<br>• F. Ibrahimi, *Koncert për violonçel dhe orkestër*<br>• F. Beqiri, *Sonata për klarinetë e piano*<br>• V. Gjini, *Këngë solo "Letrat"*<br>• Limos Disdari, *Trio për violinë, violonçel dhe piano*<br>• R. Rudi, *Afresk* arbëresh | *"Gjergj Kastrioti"*<br>• Valton Beqiri, *Alballkanica për saksofon dhe orkestër harqesh* |
| **4. KULTURA DHE SHOQËRIA** | **INTERPRETIM**:<br>• *Kënga e ditëlindjes* (e shqipëruar)<br>• S. Qefa, *Kënga jonë në festival*<br>• K. Mullai, *Mirë se vjen o vit i ri*<br>• V. Filaj, *Viti i ri*<br>• A. Grimci, *Një Qershori*<br>• *Një* qemane *e vogël*<br>• *Muzikantët e vegjël*<br>• Zilja tring (Jingle Bell - këngë | **INTERPRETIM:**<br>• *Kënga e flamurit*<br>• *Oj lum e lum po vjen Shëngjergji*<br>• Popullore, *Lul'e kuqe, lul' bojë pembe* (5/8)<br>• *U bubu krushqitë tanë* (këngë polifonike trizëshe)<br>• *Ishin dy kunata* (elbasanase)<br><br>**DËGJIM MUZIKE:**<br>• E. Rizvanolli, *Suita për piano – Suita dasmore* (suita, muzikë | **INTERPRETIM:**<br>• S. Gjoni, *Lule borë*<br>• Th. Nasi, V*lora o Vlora* (patriotike)<br>• Popullore: *O po gjeta një bilbil në vesë* (7/8)<br>• *Dola n'bahçe* (nga tradita fshatare)<br>• *Njëzetepesë gërsheta* (nga tradita qytetare)<br>• Pjesë instrumentale - Valle popullore |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | angleze e shqipëruar)<br>**DËGJIM MUZIKE:**<br>• M. Kaçinari, *Suita ilire*<br>• *Valle shqiptare*<br>• Melodi instrumentale shqiptare; orkestrina popullore, veglat e ndryshme muzikore (çifteli, fyell, def etj.). | kombëtare)<br>• F. Beqiri, *Marshi "Ala Turca"*<br>• Shpëtim Kushta, *Fantazi për violonçel dhe orkestër* (muzikë kombëtare)<br>• A. Koci, *Oj llokumja* (korale) | • *Këndon zogu* (dyzëshe)<br>• *Një baçe me lule* (trezëshe )<br><br>**DËGJIM MUZIKE**:<br>• R. Mulliqi, *Muzikë nga baleti "Nita"*<br>• Z. Ballata, "*Jehona nga bjeshkët e Nemuna*" (për piano)<br>• K. Trako, *Poema simfonike "Vendi im*"<br>• E. Rzivanolli, *Kuarteti i harqeve*<br>• B.Jashari, *Pasakalja për orkestër*<br>Këngë korale: „*Pak në ëndërr pak në zhgjëndërr"* |
| **5.**<br>**NJË BOTË PËR TË GJITHË** | **DËGJIM:**<br>• R. Dhomi, *Rondo për violonçelë dhe orkestër*<br>• B. Mulliqi, *Variacione për dy piano*<br><br>**KËNDIM:**<br>L.V. Beethoven, *Oda e Gëzimit* (tema nga simfonia e IX, e shqipëruar) | • A.Mula, *Valsi i lumturisë* (këngë)<br>• Peçi, *Çast poetik për piano*<br>• F. Beqiri, *Kuintet frymor*<br>T. Harapi, *Poemë për piano dhe orkestër* | • *Perëndeshë e bukurisë me je* (popullore e përpunuar)<br>• M. Mengjiqi, *Nënë Terezë lulkurorë* (kanon) |

### *6.5.2. Katalogu i teksteve mësimore dhe burimeve tjera mësimore:*

1. Tekstet dhe mjetet tjera mësimore që do të hartohen në bazë të kësaj kurrikule
2. Librat e edukatës muzikore që përdoren në Kosovë (kl 1-IX) dhe në Shqipëri
3. Burime me shembuj muzikorë në internet: http://muzika.albasoul.com/ dhe faqe tjera
4. Kompleti i CD-ve "100 këngët e shekullit"

## 7. UDHËZIMET DIDAKTIKE-METODIKE PËR ZBATIMIN E KURRIKULËS

Shumësia dhe larmia e interesave dhe nevojave kulturore-arsimore të nxënësve të moshave e niveleve, të kompetencave paraprake në fusha të caktuara, të niveleve arsimore kulturore të familjeve dhe të prindërve të tyre, të faktorëve tjerë socialë e psikologjikë, ndërveprimet gjuhësore e kulturore si dhe interferencat jo të pakta, posaçërisht në fushë të gjuhës dhe të kulturës, e bëjnë mësimin (marrjen dhe dhënien e tij) një veprimtari shumë komplekse dhe të vështirë, që është vështirë të akceptohet e identifikohet brenda teorive e shkollave, praktikave e standardeve të njohura të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Pra, në praktikë, të shumtën, bëhet fjalë për një veprimtari edukativo-arsimore përtej të gjitha "kornizave" e shkollave formale të punës, e cila kërkon një përgatitje interdiciplinare të mësuesit dhe shumë erudicion e kreativitet të atypëratyshëm.

Sigurisht që puna e parë që duhet të bëjë mësuesi për zbatimin e kësaj kurrikule është *përcaktimi i kompetencave* të nxënësve në fushat e caktuara. Dhe pastaj, mbi bazën e rezultateve të këtij përcaktimi-klasifikimi, mësuesi i zgjedh edhe përmbajtjet, format, mjetet, metodat, teknikat e strategjitë e punës me nxënësit si dhe me faktorët (partnerët e subjektët) tjerë mbështetës brenda dhe jashtë shkollës. Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së nxënësve. Prandaj, gjatë orës mësimore, mësuesja/si, që të arrijë rezultate optimale, mund të përdorë forma, teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra-tjetrën. Pra, vet kompleksiteti i punës e kërkon këtë shumësi didaktike-metodike dhe mjetesh, ku rol të veçantë, në kushtet dhe rrethanat konkrete, kanë format, mjetet e metodat e punës së mësimit hipermedial me ndihmën e kompjuterit-softuerit (E-Learnings*)*. Prandaj, në këtë kontekst, ambientet e pajisura mirë të mësimit në shumicën e shkollave, nëse shfrytëzohen me profesionalizëm dhe kompetencë nga mësuesi, premtojnë rezultate më të mira.

Meqë kjo kurrikul është e paraparë të realizohet në klasa të bashkuara (të kombinuara), të gjitha metodat, mjetet dhe format e punës i referohen një qasje sa komplementare dhe të integruar, po aq edhe ndërvepruese, brenda së cilës duhet të ndërtohet një model i pranueshëm i përfilljes së nevojave dhe zhvillimit të kompetencave të nxënësve si dhe i krijimit të rrethanave dhe ambientit e atmosferës joshëse e nxitëse-motivuese të punës me nxënësit, në mënyrë që ata këtë mësim ta akceptojnë më tepër si *argëtim e kënaqësi*, e sa më pak si "përshtatje" e detyrim.

Lufta për kohën e lirë dhe konkurrenca e ofertave kulturore e argëtuese në shoqëritë urbane, përballë të cilave qëndron nxënësi me etjen e tij të natyrshme për sa më shumë

lojë, argëtim dhe kohë të lirë, kërkojnë një qasje tjetër si të mësuesit ashtu edhe të prindit dhe të rrethit. Bashkëpunimi e ndërveprimi pedagogjik mësues-nxënës-prind këtu është i domosdoshëm posaçërisht për evitimin e raporteve përjashtuese. Thënë thjesht, fëmijën-nxënësin duhet *ta marrë malli për shkollën shqipe* dhe nevoja për "intervenimin" e "trysninë" e prindit apo të autoritetit tjetër duhet të jetë e reduktuar në minimum. Prandaj, duhet të zhvillohet e afirmohet përpjekja e mësuesit për të qenë sa më pak zyrtar, sa më pak i mbyllur, sa më pak i rreptë e "mësues" në kuptimin konvencional-kanonik, në njërën anë, dhe sa më shumë i hapur, i dashur, me sens e potencial të mjaftueshëm mirëkuptimi për nevojat e fëmijëve për lojë e argëtim, respektivisht *mësim* përmes "lojës", në anën tjetër.

Sa u përket formave tradicionale të punës, *puna në grupe (të madhësive të ndryshme), në çifte dhe posaçërisht ajo individuale* qëndrojnë para formës *frontale.*

Ndërkaq në fushën e metodave aplikohen më të njohurat si: *metoda e demonstrimit* **(**shpjegimi, ligjërata etj.), *metoda e punës me tekst, metoda e bashkëbisedimit* **(***diskutimet, debatet, shkëmbimi i mendimeve), metoda kërkimore-hulumtuese etj.*

Në fushën e teknikave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, tashmë në praktikën shkollore janë treguar shumë të suksesshme këto:

- *Brainstormingu ("stuhi, mendimesh", gjenerim idesh***),** që është teknikë efektive e përshtatshme të përdoret në fillim të orës mësimore;
- k*llasteri (grumbulli apo pema e mendimeve*), që nxit nxënësit për të menduar rreth një teme të caktuar dhe zakonisht shërben për të krijuar lidhje midis fakteve;
- i*nsert-i-*, si sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximin e efektshëm, që zakonisht përdoret në pjesën kryesore dhe është efektiv, sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që e lexon;
- p*esëvargëshi*, që është teknikë e veçantë e cila ka pesë vargje dhe kërkon përmbledhjen e informacionit në shprehjet të cilat përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të temës;
- *Xhigsou (ndërthurja***),** që është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, ku leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga ana e të gjithë nxënësve, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Një mori teknikash tjera si: *ditari dypjesësh, loja me role, diskutimi që zgjidh probleme, di-dua të dijë- mësova, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit, shkrimi i lirë, të mësuarit përmes projekteve, puna kërkimore në terren etj*., të përdorura përshtatshëm dhe në situata të përshtatshme didaktike, i shtojnë premisat për një sukses më të madh të mësuesit dhe të nxënësit..

Kurrikula e SHSHMP në diasporë përbëhet nga materia e integruar e këtyre fushave mësimore: *gjuhë dhe letërsi shqipe, histori, gjeografi, kulturë figurative dhe kulturë muzikore*. Brenda këtyre lëndëve janë integruar edhe lëmi tjera nga kultura shqiptare. Përmes tërësive tematike të dhëna në kurrikul, mësimdhënësi ndihmohet që të përqendrohet në tema konkrete për nivele të caktuara. Megjithatë, në paralelen me klasë të kombinuara jo vetëm që kombinohet materia e këtyre fushave mësimore, por kombinohen edhe nivelet e ndryshme të saj. Pra bashkimet–kombinimet janë shumështresore-shumëplanëshe. P.sh. në tërësinë tematike "Identiteti im" është paraparë tema "Unë jam.", e cila mund të realizohet duke iu qasur nga të gjitha fushat mësimore të kësaj kurrikule. Teksti i poezisë së Asdrenit *"Betimi mbi flamur"*, që realisht është materie për të gjitha nivelet, mund të përdoret:

- në planin g*juhësor* (nxënësi dëgjon, shkruan, lexon, reciton poezinë, e interpreton atë me shkrim apo me gojë);
- në planin *letrar* (përjetohet figura, kuptohet dallimi poezi-tregim, shijohet gjuha e poezisë, edukohet shija, zhvillohet kompetenca përkatëse etj.);
- në planin *muzikor* (dëgjohet, këndohet dhe interpretohet në instrument muzikor);
- në planin *figurativ të arteve pamore* (nxënësit mund të vizatojnë, të ngyrosin, të modelojnë flamurin, simbolet tjera kombëtare etj., por mundet edhe të bisedojnë rreth ndonjë krijimi artistik ku temë është flamuri ose ngjarjet konkrete rreth tij);
- në planin *historik* (nxënësit mësojnë për flamurin dhe momentet historike të *lidhura me të në periudha të ndryshme të historisë kombëtare);*
- *në* planin *gjeografik* (nxënësit mund të bisedojnë e mësojnë për qytetet ose rajonet e ndryshme të Atdheut të lidhura me këto momente historike, pastaj mësuesi mund të organizojë edhe temat vijuese si p.sh. përdorimi i flamurit në institucione zyrtare, në familje dhe në festa që janë gjithashtu tema të veçanta në kuadër të tërësive tematike të propozuara).

Për një punë të suksesshme e të qëndrueshme dhe njëkohësisht inkluzive, posaçërisht në kuptimin e përfshirjes së më shumë subjekteve, praktika ka dëshmuar se mësuesja/mësuesi duhet të mbështet në mënyrë të veçantë në:

- ndërtimin e një modeli funksional, të përshtatshëm me rrethanat konkrete, të *bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin shqiptar /*formimi i Këshillit të shkollës dhe Këshillit te prindërve në nivel të shkollës a lokalitetit ku punon apo edhe në nivel më të gjerë në bashkëpunim me kolegët tjerë shqiptarë dhe hartimi i planit konkret të punës me detyra e përgjegjësi të adresuara dhe me një kalendar paraprak sipas zërave të punës dhe veprimtarive,
- bashkëpunimin dhe komunikimin profesional[10] në nivel të grupimeve a organizimeve profesionale brenda qytetit, regjionit /kantonit/ a shtetit ku punon (formimi dhe zhvillimi *këshillave të mësuesve* apo organizimeve të ngjashme profesionale),
- *bashkëpunimin me shkollën dhe mësuesit e vendit mikpritës* dhe me autoritetet-subjektet tjerë në interes të vendit (posaçërisht me institucionet zyrtare nga fusha e shkollës, interkulturës, integrimit, emigracionit etj.),
- thellimin e *bashkëpunimit me institucionet e Atdheut* në të gjitha fushat (vizitat e organizuara me nxënës në Atdhe sipas projekteve dinamike kulturore-arsimore, takimet dhe seminaret e mbështetjes dhe të stërvitjes e profesionale për mësueset dhe mësuesit, pjesëmarrja në veprimtari tjera me interes etj.),
- organizimin e veprimtarive të ndryshme kulturore-arsimore në kuadër të SHSHMP në diasporë, prej të cilave tashmë janë afirmuar takimet vjetore me karakter garash dhe spektaklesh-afirmimesh kulturore, të njohura si *kampionatet apo konkurset e dijes (*kuizet) si dhe veprimtari tjera publike lokale dhe më gjerë, për të cilat paraprakisht duhet të hartohet plani i punës bashkë me kalendarin përkatës, gjithnjë duke e koordinuar punën me planet e themelatave tjera kulturore shqiptare, pastaj pjesëmarrja në veprimtaritë kulturore e ndërkulturore të vendit (programet ndërkulturore, rivistat e ndryshme e shfaqjet tjera publike ku afirmohet kultura

[10] Tashmë është e domosdoshme që për nevoja të bashkëpunimit, informimit dhe të ndërkomunikimit profesional, në të gjitha nivelet dhe në nivel të të gjithë subjekteve (të këshillave profesionale të mësuesve, të këshillave të shkollës dhe të prindërve, të shoqatave, të vet mësuesit dhe shkollës me të cilën udhëheq) të hapen Web-faqe në internet.

kombëtare si p.sh. organizimi i një manifestimi të emërtuar, ta zëmë, "*Ditët kombëtare*", që do të përfshinte prezantimin e sa më shumë elementeve të kulturës sonë kombëtare si: veshjet tradicionale, muzikën, vallet, ritet, ushqimet tradicionale, lojërat popullore dhe vlera të tjera të kulturës sonë materiale e shpirtërore.

## 7.1. Gjuhë dhe letërsi shqipe

Gjuha amtare është element kryesor i identitetit kombëtar. Prandaj mësimi i saj në shkollë, sidomos për nxënësit e mësimit plotësues në diasporë, ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Pesha e madhe e mësimit të gjuhës amtare qëndron në faktin se ajo kryen funksion të dyfishtë; në radhë të parë si lëndë mësimore e pastaj edhe si gjuhë mësimore për lëndët tjera të përcaktuara në këtë kurrikul. Korrelacioni metodik-didaktik dhe përmbajtjesor me lëndët tjera kërkon një qasje ndërdicplinare dhe aplikohet me sukses posaçërisht në mësimin me projekte.

Për nxënësit jashtë atdheut është shumë i rëndësishëm krijimi i vetëdijes mbi rëndësinë e mësimit, njohjes dhe përvetësimit gradual të gjuhës shqipe. Në këtë drejtim i tërë materiali programor i kësaj kurrikule është në përputhje me moshën dhe nivelin gjuhësor të atyre që u dedikohet. Po ashtu gjuha nuk duhet të akceptohet si qëllim për vetvete, por si mjet efikas i edukimit patriotik, zhvillimit të identitetit kombëtar dhe socializimit.

Organizimi i tërësive tematike përmes kategorive të komunikimit: *dëgjoj, flas, lexoj* dhe *shkruaj* dhe zbërthimi i tyre i mëtejshëm ofrojnë mundësi të mira të përvetësimit të njohurive themelore për sistemin e gjuhës shqipe, për tekstet letrare e joletrare dhe për formimin e tërësishëm kulturor kombëtar. Është shumë i nevojshëm zbatimi i parimit të ndërvarësisë dhe ndërveprimit në kuadër të fushave mësimore të gramatikës dhe të komunikimit (me gojë dhe me shkrim), letërsisë, teatrit, filmit etj.

Kjo fushë lëndore kërkon nga mësimdhënësi një njohje të mirë jo vetëm të gjuhës standarde shqipe, por edhe të gjuhës vendore, krahas përgatitjes së mirë profesionale të tij. Për realizimin e suksesshëm kontribuon edhe zbatimi i një qasjeje të hapur ndaj burimeve të shkruara dhe gojore si dhe posedimi e përdorimi i materialeve e pajisjeve të ndryshme teknike dhe vënia në funksion mësimor i mediumeve[11], të cilat do të ndikonin në zgjerimin dhe thellimin e njohurive gjuhësore, letrare e kulturore të nxënësve.

Para se të fillohet me realizimin e objektivave të kësaj kurrikule, mësimdhënësi përcakton *kompetencat gjuhësore ekzistuese* të nxënësve dhe në bazë të kësaj diferencon mësimdhënien individuale, duke mundësuar zhvillimin dhe përparimin gradual të secilit nxënës në përputhje me nivelin gjuhësor ekzistues. Në anën tjetër, është shumë me interes edhe identifikimi i dominancës gjuhësore në kontekstin e përkatësisë së nxënësit dhe të qenit të tij ndërmjet dy ose shumëgjuhësisë dhe konstatimi mbi bazën e kompetencave të gjuhës së parë. Zhvillimi dhe thellimi i kompetencave të gjuhës amtare përbën mbështetje të fuqishme edhe për zhvillimin intelektual të nxënësit.

Lidhur me mësimin e shkrim-leximit fillestar, puna duhet të harmonizohet-koordinohet me atë të mësuesit në gjuhën vendore, në mënyrë qe mos të krijohen situata

[11] Interneti dhe mundësitë që ofron ai janë pothuaj të pakrahasueshme, prandaj, me përkujdesjen dhe mbështetjen e mësuesit dhe të prindit, duhet të shfrytëzohet si mjet mësimor.

përjashtuese-penguese (interferenca) të panevojshme. Mbase problemi më i madh në këtë rast do të ishte përvetësimi i atyre fonemave e grafemave që i ka gjuha shqipe për dallim nga shumica e gjuhëve tjera me alfabet latin. Rekomandohet që gjuha amtare të pasojë gjuhën vendore dhe të kihet shumë kujdes në përdorimin e metodave. Në përgjithësi rikthimi kah metodat me fillim fono-sintetik dhe silabik duket se paraqet zgjidhjen më optimale profesionale, aq më tepër kur janë evidente vështirësitë në të cilat zhvillohet puna praktike. Megjithatë, në situatat kur nxënësit dëshmojnë paranjohuri të mjaftueshme dhe premisa paraprake të mjaftueshme të suksesit, metoda globale ose gjysmëglobale (edhe mikste) mund të jetë zgjidhja më e mirë. Pra, është nevojshme një shumësi e metodave me një zgjidhje të qëlluar në raport me kompetencat paraprake të nxënësve dhe aftësitë e tyre kognitive. Në fokus të punës së mësuesit të jetë ndërgjegjësimi i nxënësit për fonemat e grafemat e gjuhës amtare. Puna e veçantë me tingujt, stërvitjet e vazhdueshme të leximit, zotërimi-pasurimi i fjalësit dhe semantika e fjalës (kuptimi) janë po ashtu fusha që meritojnë kujdes të veçantë, posaçërisht në raport me gjuhën vendore.

Fakti që nxënësit në diasporë jetojnë në një shoqëri (dhe jo rrallë edhe në familje) dy – ose shume kulturore dhe ku shkollimi e komunikimi-ndërveprimi kulturor janë realitete që preken, punën e mësuesit e bën me komplekse dhe kërkon po ashtu një përgatitje të mjaftueshme profesionale dhe interdiciplinare. Mësuesi, me shkathtësi e profesionalizëm, duhet ta shfrytëzojë ndërveprimin gjuhësor, prandaj njohja e gjuhës së vendit është e domosdoshme. Gjithnjë synim parësor në punën me nxënësit duhet të jetë ngritja e tij mbi bazën e gjuhës amtare, që është edhe gjuha e identitetit të tij burimor. Duke krijuar fushë të mjaftueshme dhe të baraspeshuar për ndërveprim dhe mësim edhe kontrastiv posaçërisht në periudhën sensitive të mësimit të gjuhëve (moshat e reja), ai ua pret rrugën interferencave gjuhësore, që zakonisht janë pasojë e mungesës së kompetencës së mjaftueshme në gjuhën amtare. Në këtë mënyrë, interaksioni gjuhësor shihet si mënyrë e suksesshme zhvillimore në fushe të kompetencave gjuhësore dhe njëkohësisht reflekton pozitivisht edhe në ndërkomunikimin dinamik kulturor. Në këtë plan është i nevojshëm një bashkëpunim dinamik me mësuesin e gjuhës së vendit pritës, respektivisht ndërtimi i një korrelacioni funksional në mësimin e gjuhës amtare dhe të gjuhës tjetër.

Po ashtu, mësuesi duhet të ketë parasysh faktin që nxënësit vijnë nga rajone të ndryshme të Atdheut, ku të shumtën e rasteve gjuha e tyre shqipe e familjes është ose dialektore ose lokale (jo standarde), prandaj ai (mësimdhënësi) duhet të jetë fleksibil dhe jo përjashtues në raportet me dialektet dhe, duke vepruar me profesionalizëm, të insistojë në përvetësimin e gjuhës standarde shqipe. Gjuha shqipe jashtë Atdheut, edhe kur nuk është standarde në masën e dëshirueshme, gjithnjë identifikohet me Atdheun. Ndërsa Atdheu i origjinës është krenaria e parë e njeriut. Prandaj, fleksibiliteti dhe durimi janë tipare të pashmangshme të mësuesit të suksesshëm. Të gjitha këto duhet të jenë në funksion të motivimit edhe të nxënësit, edhe të mësuesit. Në këtë kontekst mësuesi me krenari e sheh rolin e tij personal edhe prej *misionari.*

## 7.2. Histori

Zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj vlerave, traditës, besimit dhe kulturës së popullit shqiptar është një nga qëllimet më të rëndësishme të kësaj kurrikule. Qasja e mësimdhënies në realizimin e temave nga fusha lëndore e historisë përkon me natyrën e integruar të kurrikulës dhe nuk e përfill vijën kronologjike të ngjarjeve, por i referohet ndërveprimit kurrikular-ndërpërmbajtjesor.

Në mënyrë të veçantë mësimdhënësi i motivon nxënësit për zhvillimin e të menduarit historik multiperspektiv (të hapur për diversitetin dhe shumësinë e pikëpamjeve të historisë, duke përfshirë aspektin shoqëror, kulturor, ekonomik, politik etj.).

Metodat e mësimdhënies duhet t'i mundësojnë nxënësit që të zhvillojë njohuritë (informacionet faktike për të kaluarën), shkathtësitë (e analizës dhe të reflektimit kritik mbi shkaqet e pasojat e ngjarjeve historike) si dhe qëndrimet personale ndaj ngjarjeve historike.

Temat e propozuara të kësaj kurrikule nga fusha lëndore e historisë kanë për qëllim që të zhvillojnë këtë qëndrim pozitiv të nxënësve dhe ndjenjën e krenarisë për identitetin e tyre kombëtar bashkë me qëndrimin tolerant e dashamirës ndaj popujve të tjerë në kuadër të familjes evropiane dhe më gjerë.

Këto tema zgjedhën në përputhje me nivelin dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit e të shkruarit) dhe duke nxitur në mënyrë të veçantë analizën si dhe reflektimin kritik ndaj fakteve dhe burimeve konkrete. Ato shumë mirë mund të kombinohen edhe me historinë e zhvillimit të gjuhës amtare, të letërsisë dhe të arteve tjera e të kulturës kombëtare shpirtërore e materiale dhe në rastin konkret ndërvep-rohen brenda përmbajtjeve e njësive konkrete, të përfshira në këtë kurrikul.

Për të realizuar këtë fushë lëndore, mësimdhënësi përdor mjete të ndryshme si p.sh. hartat, burimet e shkruara, burimet gojore, materiale, pajisjet multimediale e të tjera, duke mos lënë anash edhe vizitat praktike në lokacione të ndryshme historike, në muze, në galeri etj. Një aktivitet i të mësuarit me shumë interes dhe, sa mbështetës po aq edhe i dashur për nxënësit, do të ishte *ekskursioni në Atdhe,* por gjithnjë si vizitë e organizuar me qëllim njohës e mësimor dhe edukativ.

Mësuesi do të kujdeset që të aplikojë njërën prej metodave më interesante të mësimdhënies bashkëkohore të historisë, të ashtuquajturën metoda e *historisë orale,* që përqendrohet në rrëfimet e dëshmitarëve të gjallë të ngjarjeve të ndryshme historike.

Përmes projekteve të vogla në tema të caktuara, ku mund të ngërthehen të gjitha aspektet e zhvillimit historik të shoqërisë (politika, ekonomia, arti e kultura), inkurajohet mendimi kritik dhe puna e pavarur e hulumtuese (individuale dhe grupore).

## 7.3. Gjeografi

Për realizimin me sukses të temave nga gjeografia e Atdheut për mësimin shqip në diasporë është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojshme të punës dhe një kompleks i tërë procedurash: informacioni i ri, përsëritje, përforcim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike etj. Përdorimi i mjeteve mësimore siç janë: skicat, vizatimet, peizazhet, hartat, modelet, diagramet, grafikonet, instrumentet dhe mjetet të tjera teknike bashkëkohore (kompjuteri, interneti) e konkretizojnë mësimin nga kjo fushë lëndore dhe stimulojnë nxënësit për punë të pavarur e hulumtuese.

Qasja ndaj temave, që i takojnë kësaj fushe lëndore, duhet të jetë krejtësisht praktike dhe në funksion të përdorimit të gjuhës për nevoja të komunikimit me gojë dhe me shkrim si dhe në funksion të aftësisë për lexim, analizë dhe interpretim të materialeve (teksteve) që kanë të bëjnë me këto tema. Funksioni tjetër është njohës, gjegjësisht është marrje e informacioneve të ndryshme e të mjaftueshme për relievin, florën, faunën, vendbanimet (fshatrat dhe qytetet), popullsinë dhe organizimin shoqëror të Atdheut në përputhje me nivelin e caktuar dhe në bashkërenditje me mësimet që nxënësit marrin nga

kjo fushë mësimore në mësimin bazë. Prandaj, mësimdhënësi i mësimit shqip në Diasporë patjetër duhet të bashkëpunojë me mësimdhënësin e kësaj lënde ose fushë mësimore në mësimin bazë, për të pasur parasysh njohuritë paraprake që kanë nxënësit nga kjo fushë dhe për të arritur që sidomos në nivelin e tretë të analizojnë dhe të krahasojnë njohuritë mbi aspektet gjeografike të vendit ku jetojnë me ato për Atdheun.

## 7.4. Kultura muzikore

Në këtë fushë përmbajtjet janë kryesisht të orientuara në funksionin e muzikës për edukimin patriotik duke i zhvilluar te nxënësit njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e shprehitë pozitive në raport me artin muzikor kombëtar.

Duke pasur parasysh faktin se mësimdhënia e muzikës është e mundshme të realizohet në mënyrë të suksesshme vetëm nga mësimdhënësi i cili ka përgatitje solide muzikore (së paku të ketë vijuar shkollën e ultë ose të mesme të muzikës apo të kenë mbaruar ish Shkollën Normale), ku në të vërtetë vetëm një numër simbolik i mësimdhënësve që realizojnë mësimin shqip në diasporë mund ta kenë këtë përgatitje, rekomandojmë që mësimdhënësi të bashkëpunojë shumë ngushtë me profesionistë të muzikës si p.sh. me mësimdhënësin e muzikës së shkollës ku nxënësit vijojnë mësimin e rregullt, me prindërit, me muziktarë që veprojnë në grupe e shoqata të ndryshme profesionale e amatore muzikore-kulturore. Mësuesi i shkathtë një ndihmë të konsiderueshme mund të ketë edhe nga nxënësit e tij që ndjekin shkolla muzike ose arsimim shtesë muzikor në fusha të caktuara. Një raport ndërveprues dhe partneriteti me ta paraqet përparësi profesionale të mësuesit dhe rritje të suksesit të tij dhe të nxënësve. Gjithë kjo do të thotë se është shumë i mirëseardhur inkurajimi i nxënësve të talentuar në këndim apo lojë instrumentale, që ata të marrin iniciativën e realizimit muzikor të shembujve, në rastet kur mësimdhënësi nuk ka përgatitjen e duhur muzikore.

Mësimdhënësi ka për obligim të realizojë materialin muzikor të propozuar në këtë kurrikul për t'i përmbushur objektivat e mësimit plotësues në diasporë.

Në këtë lloj mësimi kryesisht do të përdoren dy veprimtaritë kryesore muzikore:

a) *interpretimi* (këndimi dhe interpretimi në instrumente muzikore),

b) *dëgjimi i muzikës*

### *a) Interpretimi muzikor*

Mësimdhënësi gjatë zgjedhjes së këngëve dhe të melodive instrumentale duhet të udhëhiqet kryesisht nga shembujt e propozuar në katalogun e kësaj kurrikule. Përzgjedhja e materialit muzikor (këngëve për këndim ose melodive instrumentale) është bërë ose bëhet /në rastet shtesë/ në përputhje me temat mësimore të propozuara nga fushat e tjera mësimore të kësaj kurrikule.

*Në fushën e këndimit* kënga popullore është më e afërt për fëmijët, ngase ajo është pjesë e pandashme e rritës dhe zhvillimit të tyre dhe i shoqëron ata në familje dhe më gjerë. Zgjedhën këngët më përfaqësuese dhe që paraqesin margaritarë të këngës popullore shqiptare, gjithnjë duke pasur parasysh njëkohësisht përmbajtjen e tyre tekstore, e cila duhet t'i përgjigjet moshës dhe aftësive të tyre marrëse. Meqë këngët tregojnë shpirtin e një populli, është mirë që mësimdhënësi të jetë sa më gjithëpërfshirës në gjeografinë e

këngës popullore shqiptare, duke përfshirë këngë, melodi, lojëra e valle nga të gjitha trojet shqiptare. Nga aspekti metodik muzikor, këngët duhet të këndohen në intonacion sa më të saktë ose me imitim, ose duke u ndihmuar me tekstin notal muzikor. Kënga mundësisht të shoqërohet me përcjellje instrumentale nga mësimdhënësi ose nga nxënësit që interpretojnë në ndonjë instrument muzikor. Ndihmesë për mësimdhënësin mund të jenë edhe reproduktimet e ndryshme që mundësohen nga përdorimi dhe njohja e teknologjisë bashkëkohore: CD-të origjinale, prezantime multimediale (DVD, video etj), MP3, MP4, pastaj materiale të autorizuara dhe legale që mund të gjinden në internet etj.

Por, megjithatë, mësimdhënësi duhet ta dijë se asgjë nuk mund ta zëvendësojë këndimin origjinal (të gjallë) dhe emocionet e fuqishme që nxënësit përjetojnë me atë rast.

Në fushën e *lojës në instrumente muzikore* mësuesi bashkëpunon e koordinon veçmas me nxënësit e angazhuar në kuadër të shkollimit të rregullt, të cilët duke e njohur përdorimin e instrumenteve muzikore të fëmijëve (të ORFI-t) për shoqërimin ritmik të këngëve që i këndojnë në klasë, por edhe për interpretim të melodive të thjeshta muzikore, janë mbështetje e mirë edhe për mësimin e muzikës shqiptare. Kjo duhet të pasurohet me futjen në përdorim edhe të instrumenteve muzikore popullore, që përdoren në muzikën shqiptare si: çiftelia, dajrja (defi), fyelli e instrumente të tjera popullore (gërrenjëza, daullet e vogla, bilbili etj.). Nxënësit duhet të inkurajohen për shoqërim ritmik apo harmonik të këngëve dhe luajtje të veçanta instrumentale në kuadër të aktiviteteve të lira në shkollë dhe jashtë saj.

### *b) Dëgjimi i muzikës*

Dëgjimi i muzikës është veprimtari edukative e arsimore muzikore që, në këtë lloj mësimi, ka për synim kryesor zgjerimin e njohurive të nxënësve për krijimtarinë muzikore kombëtare përmes dëgjimit dhe përjetimi estetik të veprave konkrete muzikore.

Në këtë veprimtari mësimdhënësi zgjedh shembujt muzikorë për dëgjim, duke u bazuar në dy aspekte:

1. Materialet mësimore që punohen të jenë në përputhje me tërësitë tematike të propozuara dhe të jenë në funksion të plotësimit të realizimit të objektivave konkrete për ato tërësi tematike;

2. Të fokusohen figurat dhe veprat e shquara përfaqësuese kombëtare të të gjitha zhanreve të muzikës shqiptare, që do të thotë përfshirje e krijuesve (kompozitorëve) dhe interpretuesve muzikorë, të cilët e përfaqësojnë denjësisht muzikën shqiptare në botë.

Në kuadër të kësaj veprimtarie, në nivelin e dytë dhe të tretë, nxënësit nxiten edhe për reflektim e vlerësim individual të zhvillimeve muzikore në Atdhe, duke i krahasuar ato me trendet aktuale të zhvillimeve muzikore në vendin ku jetojnë e edhe më gjerë. Në këtë rast zgjerohet horizonti i njohurive të tyre nga fusha e muzikës kombëtare dhe njëkohësisht zhvillohen edhe kompetencat gjuhësore për komunikim e prezantim (me gojë dhe me shkrim) individual e në grupe mbi këto tema.

Ndërveprimi me fushat tjera lëndore të kurrikulës është i domosdoshëm, ngase vet lloji i mësimit të integruar të paraparë me këtë kurrikul, kërkon që muzika të jetë në shërbim të zhvillimit të ndjenjës e të identitetit kombëtar dhe të aftësimit të nxënësve për të komunikuar e për t’u shprehur në gjuhën shqipe.

## 7.5. Kultura figurative

Në mësimin shqip në diasporë, kultura figurative ka për qëllim kryesisht njohjen me vlerat artistike kombëtare. Kjo bëhet duke iu ofruar nxënësve veprat më të shquara e antologjike të krijuesve që kanë bërë emër në Atdhe, por edhe në nivel ndërkombëtar. Ato ofrohen, shijohen e përjetohen në origjinal, kur ka mundësi, por edhe përmes reproduktimeve në tekste, në multimedia, internet etj.

Nxënësit inkurajohen që të përdorin mjete e materiale të ndryshme dhe shkathtësitë e tyre krijuese që i zotërojnë tashmë për t'u shprehur figurativisht në lidhje me temat e caktuara.

Zakonisht ata udhëzohen që këto krijime t'i bëjnë si detyra të pavarura në shtëpi ose në kuadër të mësimit në shkollën vendore.

Mësimdhënësi udhëzohet që të realizojë me nxënësit vizita te krijuesit e njohur shqiptarë që jetojnë e veprojnë në vende te ndryshme (aty ku ka mundësi) si dhe vizita në galeri e muze (ku ruhen edhe vepra shqiptare). Në këtë plan, zhvillimi i një shpirti kërkues-hulumtues për veprat dhe krijuesit shqiptarë jashtë Atdheut, është i domosdoshëm..

Nxënësit, po ashtu, udhëzohen për realizimin e projekteve të ndryshme të pavarura kur janë në Atdhe (krijime, biseda me krijues, vizita galerive kombëtare ose atyre private të krijuesve të shquar) dhe forma tjera që i nxisin ata të kenë qëndrim pozitiv ndaj artit figurativ kombëtar.

Mësimdhënësi, në programet kulturore publike të përgjithshme në kuadër të SHSHMP në diasporë apo të aktiviteteve kulturore të komunitetit shqiptar në mjedisin ku gjendet shkolla si dhe në programe e projekte ndërkulturore (por edhe të veçanta e tematike), duhet të organizojë dhe të bashkorganizojë ekspozita të punimeve më të mira të nxënësve, të cilat e afirmojnë punën e tyre dhe i vënë ata në raporte interaktive të komunikimit kulturor-artistik me veten, familjen, rrethin, komunitetin që i përkasin dhe njëkohësisht edukohen më tej.

Pra, për realizimin me sukses të kësaj kurrikule, bashkëpunimi me familjet dhe komunitetin më të gjerë është shumë i rëndësishëm për të formuar personalitetin e tij nga aspekti kulturor-kombëtar. Nxënësi duhet të vetëdijesohet dhe të motivohet që në vendin ku jeton këtë kulturë ta prezantojë si pjesë të identitetit të tij personal dhe kombëtar dhe të jetë krenar me të.

Mësimdhënësi i mësimit plotësues të shkollës shqipe në diasporë gjatë vitit shkollor organizon dhe prezanton para shkollës, prindërve dhe komunitetit programe të larmishme kulturore-artistike kombëtare.

# 8. KUADRI DHE PËRGATITJA PROFESIONALE

Meqë sistemi ynë shkollor ende nuk përgatit kuadër përkatës profesional për SHSHMP në diasporë, mësimin orientimisht mund ta mbajnë mësuese-mësues të;

- gjuhës dhe letërsisë shqipe,
- historisë,
- gjeografisë,

- kulturës muzikore,
- mësues klase, etj.

Megjithatë, përkrah këtyre kritereve formale të kualifikimit shkollor, mësuesja-mësuesi i SHSHMP në diasporë posaçërisht duhet të dëshmojë:

  - njohje të shkëlqyeshme të gjuhës dhe letërsisë shqipe (gjuha standarde, gramatika, drejtshkrimi, drejtshqiptimi, stilistika, fjalësi, letërsia etj.),
  - përgatitje dhe aftësi solide në të gjitha veprimtaritë themelore gjuhësore (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lexuarit)
  - njohje të mjaftueshme të përgjithshme të kulturës shqiptare,
- njohje të historisë dhe të gjeografisë së Atdheut,
- njohje të artit të muzikës dhe të arteve pamore,
- njohje të mjaftueshme të kulturës shqiptare në përgjithësi,
- edukim të mjaftueshëm artistik muzikor dhe figurativ,
  - aftësi e shkathtësi interpretuese në këndim, vallëzim, instrumente muzikore, lojë etj.

Mësueset dhe mësuesit vazhdimisht duhet t'i thellojnë kompetencat e tyre profesionale dhe t'i ndjekin seminaret dhe format tjera të aftësimit të vazhdueshëm profesional që i zhvillojnë institucionet e shtetit ku punojnë e jetojnë si dhe ato të institucioneve të Atdheut, në mënyrë të veçantë projektet e MASHT të Kosovës, MASH të Shqipërisë etj.

## 9. PAJISJET DHE HAPËSIRA

Pamundësia për ta bërë një zgjedhje unike ose përafërsisht unike në kuptim të organizimit dhe të kushteve të punës së SHSHMP në diasporë, për shkak se aktualisht në shtete dhe rrethana të ndryshme ekzistojnë forma e mënyra të ndryshme të organizimit të MP në gjuhën amtare dhe me status jo të njëjtë (prej formave vendore zyrtare si; *mësim i integruar* ose *gjysme i integruar*, *mësim integrativ*, *kurse të gjuhës dhe kulturës së origjinës*, kurse të tilla mbi bazën e *projeketve të përkohshme interkulturore* e deri te zgjidhjet sipas *formave të vetorganizimit qytetar kulturor-arsimor* të qytetarëve tanë; *shkolla dhe kurse në kuadër të shoqatave e klubeve* e deri sosh *private-komerciale)*, nuk lë mjaft shteg për të folur për standardet e hapësirës dhe të pajisjeve. Parësore është që të punohet në realizimin e të drejtës së shfrytëzimit pa kufizime dhe mjaftueshëm të hapësirave shkollore si dhe e përdorimit të të gjitha pajisjeve dhe mjeteve mësimore që posedon shkolla vendore. Është e domosdoshme edhe puna ne krijimin e mediotekave për nevoja të SHSHMP, ku përveç librave (biblioteka) dhe mediumeve tjera deri tradicionale, rol parësor do të kishte sigurimi dhe shfrytëzimi me kulturë profesionale i mjeteve moderne (kompjuteri, CD-ROM, DVD, interneti). Përdorimi i internetit si mjet mësimor realisht duhet të favorizohet dhe nënkupton edhe orientim kah përgatitja për informatizim

të SHSHMP në diasporë. Mësuesit, po ashtu, japin edhe udhëzimet përkatëse për përdorimin në shtëpi të portaleve të ndryshme mësimore-kulturore që ekzistojnë apo edhe mund të bëhen në ndërkohë (edhe mbi bazën e kësaj kurrikule).

## 10. VLERESIMI I KOMPETENCAVE

Verifikimi dhe vlerësimi i shkallës së përvetësimit të diturive nga nxënësit është proces tepër i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të kësaj kurrikule. Për këtë arsye rekomandohet që vlerësimi të përqendrohet më tepër në aspektin cilësor të arritjes së objektivave të përgjithshme dhe specifike të kësaj kurrikule.

Aktualisht bëhet kryesisht i ashtuquajturi vlerësim i brendshëm. Por, në rrethana me favorite, mund të aplikohet edhe vlerësimi i jashtëm.

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe sistematik i arritjes së nxënësit me qëllim që:

- të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve,
- t`u sigurojë nxënësve informacion mbi arritjen e tyre,.
- t`i motivojë nxënësit,
- të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuara,
- të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Në planin tipologjik, mësuesja/i, varësisht prej situatës konkrete, do të zbatojë-aplikojë tipa tashmë të njohur të vlerësimit si:

- *vlerësimin diagnostikues***,** i cili te nxënësi përcakton dobësitë, vështirësitë, problemet dhe njëkohësisht i identifikon edhe nxënësit me nevoja të veçanta,
- *vlerësimin formues***,** i cili e udhëzon mësuesin në planifikim, kurse nxënësit i ndihmon në identifikimin e vështirësive gjatë nxënies (punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme.
- *vlerësimin klasifikues* përmes të cilit **c**akton pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotëruara paraprake dhe objektivat e parashikuara,
- *vlerësimin në bazë të kritereve***,** që i referohet përmbushjes së kritereve të caktuara në raport me një standard të caktuar dhe ku mësuesi siguron informacion të mjaftueshëm për identifikimin e vështirësive të nxënësve dhe caktimin e modaliteteve për kapërcimin e tyre,
- *vetëvlerësimin,* që realisht është proces i mbledhjes, analizimit, interpretimit të informative dhe veprimtarisë dhe që nxënësi e bën vet me anë të ndonjë mjeti vlerësues.
- *vlerësimin përmbledhës***,** i cili bëhet me qëllim që të zbulojë shkallën e arritjes së objektivave pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies (p.sh. pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj.).

Në anën tjetër vlerësimin duhet kuptuar si një veprimtari, që bazohet në *kontrollin e përditshëm* të punës së nxënësit në klasë dhe po ashtu duhet të jetë edhe një *proces,* që i referohet mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim etj. Në fund të vitit bëhet i ashtuquajturi *vlerësimi përfundimtar,* që është një punë komplekse-sintetike dhe duhet të jetë sa më afër saktësisë e objektivitetit.

*Detyrat e shtëpisë* dh*e puna e pavarur* sigurojnë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara. Në rast të paraqitjes së vështirësive, ndihma e prindit është e dobishme deri në

masën kur nxënësi vetëm ndihmohet që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës së kërkuar nga mësimdhënësi.

Mësimdhënësi duhet të zgjedhë dhe të zbatojë numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, ndër të cilat më të njohurat janë:

- vrojtimi,
- pyetësori (vetëvlerësimi),
- raporti me shkrim i një punë praktike apo i një hulumtimi,
- të shprehurit me gojë,
- të shprehurit me shkrim,
- performansa artistike,
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi),
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje) me përgjigje alternative të shumta, me përgjigje të hapura të shkurta dhe me përgjigje të hapura të zgjedhura.

Notimi i nxënësve bëhet në formë përshkrimi sipas tri shkallëve të vlerësimit:

- *nuk ka kënaqur,*

- *i /e/ suksesshëm /*me,

- *i /e/ shkëlqyeshëm/me*

Në përputhje me dispozitat dhe kriteret vendore, nota bartet në dokumentin /librezën a dëftesën/ e nxënësit. Po ashtu, në përputhje me dispozitat e vendit pritës, ajo do të duhej të ndikonte edhe në suksesin e përgjithshëm të nxënësit në shkollën e rregullt. Nota do të bartet edhe në dokumentet tjera të nxënësit, të nxjerra nga bartësit e SHSHMP në diasporë.

## 11. PLANI MËSIMOR ORIENTUES[12]

| Nr. | Lëndët-fushat mësimore | Numri vjetor i orëve sipas niveleve | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Niveli i parë (kl.I-III) | Niveli i dytë (kl. IV-VI) | Niveli i tretë (kl. VII-IX) |
| 1 | Gjuhë dhe letërsi shqipe | 46 | 46 | 46 |
| 2 | Histori | 4 | 8 | 8 |
| 3 | Gjeografi | 4 | 7 | 7 |
| 4 | Kulturë muzikore | 10 | 6 | 6 |
| 5 | Kulturë figurative | 7 | 4 | 4 |
| 6 | Fusha tjera | 1 | 1 | 1 |
| **GJ** | | **72** | **72** | **72** |

[12] Ky plan është vetëm orientues dhe nuk pretendon të jetë përcaktues-kufizues në aspektin e relevancave lëndore. Vet karakteri integrativ dhe ndërveprues i mësimit, i cili të shumtën do të jetë një mësim i diferencuar, i relativizon skemat e përqindjeve konvencionale të përcaktuara-paragjykuara paraprakisht. Pra, në këtë kontekst nuk duhet krijuar përshtypjen e rrejshme për “dominimin” e gjuhës dhe të letërsisë shqipe, sepse një shumicë objektivash (edhe të lëndëve tjera) realizohen përmes kësaj lënde.

### *11.1. Plani mësimor i gjuhës dhe letërsisë shqipe*

| Niveli | Klasat | Numri vjetor i orëve | Leximi dhe shkrimi fillestar | Letërsia | Gjuha | Kultura e të shprehurit | Kultura mediale dhe komunikimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| I | 1 | 46 | 34 | 4 | 4 | 3 | 1 |
| | 2 | 46 | 7 | 17 | 10 | 10 | 2 |
| | 3 | 46 | 7 | 17 | 10 | 10 | 2 |
| II | 4 | 46 | | 23 | 11 | 10 | 2 |
| | 5 | 46 | | 23 | 11 | 10 | 2 |
| | 6 | 46 | | 23 | 11 | 10 | 2 |
| III | 7 | 46 | | 23 | 11 | 10 | 2 |
| | 8 | 46 | | 23 | 11 | 10 | 2 |
| | 9 | 46 | | 23 | 11 | 10 | 2 |

Përgatiti për shtyp: SHTËPIA BOTUESE LIBRI SHKOLLOR – Prishtinë
Shtypi: Shtypshkronja xxxxxx – Prishtinë

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

372.3(=18:4/9)

Kurrikula e shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë / [Redaksia Fehmi Ismajli… et al.]. – Prishtinë : Ministria e arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë e Kosovës, 2007. – 80f. ; 24 cm.

1. Ismajli, Fehmi

**ISBN 978-9951-07-16-029-2**

UNMIK IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA
QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

| | | |
|---|---|---|
| MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË | MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY | MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE NAUKU I TEHNOLOGIJU |
| Kabineti i Ministrit | Office of the Minister | Kabinet Ministra |

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**
**Zbatimi i kurrikulit të shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë**

**NUMËR : 50 /2007**
**DATË: 13.11.2007**

Në bazë të pikës (b) të nenit 6.1, të nenit 12.2 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm si dhe në bazë të pikës (d) të nenit 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), si dhe paragrafit 7 të nenit 25 të Rregullores së Qeverisë nr. 01/2007 për punën e Qeverisë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

**Neni 1**
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi administrativ është zbatimi i kurrikulit të shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

**Neni 2**
**Kurrikuli**

Kurrikuli i shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë i është bashkangjitur këtij Udhëzimi administrativ.

**Neni 3**
**Zbatueshmëria**

1. Kurrikuli i shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë zbatohet nga viti shkollor 2008/2009.
2. Me zbatimin e kurrikulit të shkollës shqipe të mësimit plotësues në diasporë shfuqizohen planet dhe programet e deritashme edukative-arsimore të mësimit plotësues në diasporë.

**Neni 4**
**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

Agim Veliu, Ministër